



Republika e Kosovës

Republika Kosova / Republic of Kosovo



Agjencia kundër Korrupsionit

Agencija protiv Korupcije / Anti-Corruption Agency

Raport Vjetor

Janar – Dhjetor 2014

Prishtinë, Mars 2015

Përmbajtja:

Lista e tabelave	ii
Lista e grafikëve	ii
Lista e shkurtesave	iii
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
2. KORNIZA LIGJORE	1
3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	2
4. ORGANIZIMI I BRENDSHËM	3
5. AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE	4
5.1 LUFTIMI I KORRUPSIONIT	4
5.1.1 Zbatimi i ligjit	4
5.1.2 Zhvillimi i hetimeve	4
5.1.3 Bashkëpunimi me institucionet tjera që kanë për mision luftimin dhe parandalimin e korrupsionit	16
5.2 Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit 2013-2017 ...	18
6. PARANDALIMI I KORRUPSIONIT	19
6.1 Mbikëqyrja dhe kontrolli i pasurisë dhe i dhuratave	19
6.1.1 Llojet e deklarimit të pasurisë	19
6.1.2 Kontrolli i deklarimit të pasurisë	22
6.1.3 Katalogu i dhuratave	23
6.2 Parandalimi i konfliktit të interesit	25
6.3 Parandalimi i Korrupsionit në aktivitetet e Prokurimit Publik	27
6.3.1 Opinionet parandaluese	28
7. Mbështetja profesionale dhe Marrëdhëniet me Publikun	32
7.1 Zyra për Mbështetje, Bashkëpunim dhe Informim	32
7.2 Resurset njerëzore	36
7.3 Prokurimi Publik	36
8. Administrata Buxheti dhe Financat	36
9. ADRESIMI I REKOMANDIMEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITSHËM	38
10. MËSIMET DHE REKOMANDIMET	39
11. PËRFUNDIMI	39
SHTOJCAT	40
Aneksi I . Organogrami i Agjencisë kundër Korrupsionit	40
Aneksi II Tabela e trajnimeve gjatë vitit 2014	41

Lista e tabelave

Tabela 1. Rastet e përcjella nëpër organet kompetente që nga funksionalizimi i AKK-së.....	13
Tabela 2. Vendimet e Gjykatave sipas Nenit 437 të KPK	15
Tabela 3. Aktgjykimet dënuese nga gjykatat sipas nenit 437 të KPK.....	15
Tabela 4. Deklarimi i rregullt vjetor	20
Tabela 5. Deklarimi me marrjen e detyrës.....	20
Tabela 6. Deklarimi sipas kërkesës së AKK-së.....	21
Tabela 7. Deklarimi i pasurisë pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni publik.....	21
Tabela 8. Pasqyrimi i deklarimit vjetor për të gjitha llojet.....	21
Tabela 9. Procesi i përgjithshëm i deklarimit të pasurisë si dhe rezultatet e gjetjeve nga kontrolli i plotë.....	22
Tabela 10. Pasqyra e pranimit të dhuratave nëpër institucione.	23
Tabela 11. Pasqyra e kontrollit të dhuratave sipas institucioneve	24
Tabela 12. Rastet e trajtuara në total për konflikt të interesit gjatë vitit 2014.....	26
Tabela 13. Funksionet e shumëfishta	27
Tabela 14. Pasqyra e rezultateve të lëndëve të trajtuara.....	28
Tabela 15. Aktivitetet e ndërprera të prokurimit mbi bazën e opinionëve të AKK-së.....	31
Tabela 16. Pasqyra e rasteve që nuk është ndërprerë aktiviteti i prokurimit nga Autoritetet Kontraktuese.....	32
Tabela 17. Pasqyra e aktiviteteve të Prokurimit Publik	36
Tabela 18. Pasqyra e ndarjeve buxhetore sipas kategorive ekonomike.....	37
Tabela 19. Pasqyra e realizimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike	37
Tabela 20. Pasqyra e rekomandimeve nga zyra e auditorit të përgjithshëm	38
Tabela All. Lista e trajnimeve gjatë vitit 2014.....	43

Lista e grafikëve

Grafiku 1. Pasqyrimi i procedimit të rasteve të trajtuara gjatë vitit 2014	5
Grafiku 2. Pasqyrimi i Kallëzimeve Penale dhe numrit të personave të përfshirë të përcjella në institucionet përkatëse	6
Grafiku 3. Numri i rasteve të përcjella në organet kompetente si dhe personat e përfshirë (2007-2014)	12
Grafiku 4. Monitorimi i zbatimit të Strategjisë	18
Grafiku 5. Shkrimet për Korrupsion në shtypin ditor sipas muajve gjatë vitit 2014.....	33
Grafiku 6. Numri i shkrimeve të gjitha mediave të shkruara për punën e Agjencisë	34

Lista e shkurtesave

PSH	<i>Prokuroria e Shtetit</i>
PSRK	<i>Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës</i>
PPQ	<i>Prokuroria Publike e Qarkut</i>
PPK	<i>Prokuroria Publike Komunale</i>
PTH	<i>Prokuroria Themelore</i>
IP	<i>Inspektorati Policor</i>
FIU	<i>Financial Investigation Unit</i>
UP	<i>Universiteti i Prishtinës</i>
GJK	<i>Gjykata Kushtetuese</i>
MASHT	<i>Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë</i>
MEF	<i>Ministria e Ekonomisë dhe Financave</i>
KQZ	<i>Komisioni Qendror Zgjedhor</i>
KRPP	<i>Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik</i>
KEK	<i>Korporata Energjetike e Kosovës</i>
KDI	<i>Kosovo Democratic Institute</i>
QKSPEZH	<i>Qendra e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim</i>
FLSA	<i>Financial Laë Smart Agency</i>
IKAP	<i>Instituti Kosovar për Administratë Publike</i>
LDC	<i>Leadership and Development Consultancy</i>
RESPA	<i>Regional School for Public Administration</i>
BRC	<i>Bratislava Region Center</i>
UNDP	<i>United Nation Development Program</i>
ASHAK	<i>Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës</i>
SACIK	<i>Suport Anty-Corruption Insitution's of Kosovo</i>
EU	<i>European Union</i>
MDA	<i>Menagment Development Aosiacion</i>
SPV	<i>Strategjia dhe Plani i Veprimit Agjencia kundër Korrupsionit</i>

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Agjencia kundër Korrupsionit tash e sa vite është duke punuar me përkushtimin drejtë krijimit të një ambienti shoqëror të lirë nga ndikimi i korrupsionit. Në këtë rrafsh janë përcaktuar prioritete të çarta për zbatimin e legjislacionit, parandalimin e korrupsionit, promovimin e transparencës dhe forcimin e integritetit institucional.

Përkundër zotimeve të përgjithshme nga të gjitha institucionet relevante për hapa konkret kundër korrupsionit, megjithatë veprat penale të korrupsionit vazhdojnë të përbëjnë numrin më të vogël të veprave me dënime të shqiptuara.

Bazuar në të dhënat e këtij raporti vërehet se nevojiten përpjekje të përbashkëta të kompletë sistemit të drejtësisë si dhe mekanizmave të tjerë që kanë për mision luftën kundër korrupsionit në mënyrë që të ndërtohet një sistem i fuqishme institucionale që prodhon rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit dhe përfundimisht të krijohet fryma e besimit qytetar.

Në kontekstin e Agjencisë, ky institucion që nga funksionalizimi e deri në momentin e raportimit, nga të gjitha rastet e hetuara ku janë gjetur prova për vërtetimin e dyshimeve për veprime korruptive, i ka përcjell në prokuroritë kompetente, prokurorinë e EULEX-it, Policinë e Kosovës, Inspektoratin Policor të Kosovës dhe Njësinë e Hetimeve Financiare, gjithsejtë 552 raste. Siç do vërehet në kapitujt e më poshtëm të këtij raporti, gjatë kësaj periudhe raportuese AKK ka adresuar numrin më të madh të kallëzimeve penale në raport me vitet paraprake. Kjo është si rrjedhojë që Kodi Penal i Kosovës (i hyrë në fuqi në fillim të vitit 2013) mos deklarimin e pasurisë dhe deklarimin e rremë të saj i parasheh si vepra penale.

Një karakteristik që është vërejtur gjatë periudhës raportuese është hedhja poshtë e rasteve të Agjencisë nga ana e Prokurorive, sidomos të atyre veprave që kanë të bëjnë me dyshime për shkelje të parimeve dhe rregullave që i parasheh Ligji i Prokurimit Publik.

Ky raport vjetor që mbulon periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2014, i cili i adresohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, është i teti me radhë. I ndarë në disa kapituj raporti pasqyron në detaje të gjitha aktivitetet dhe iniciativat e ndërmarra nga Agjencia për këtë periudhë kohore.

2. KORNIZA LIGJORE

Korniza ligjore bazë sipas të cilës Agjencia e ushtron mandatin e saj ligjor janë aktet në vijim:

1. Ligji nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit
2. Ligji nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë
3. Ligji nr. 04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë, (i cili ka hyrë në fuqi më 2014);
4. Ligji nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik

Gjatë vitit 2014, është punuar edhe në fushën e legjislacionit dytësor, përkatësisht në nxjerrjen e akteve nënligjore, të cilat e ndihmojnë punën e Agjencisë. Në këtë vit janë nxjerrë këto akte juridike:

1. Rregullorja nr. 01/2014 e Punës e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
2. Rregullorja nr. 02/2014 për Organizimin, Funkzionimin dhe Menaxhimin e Arkivit të Agjencisë kundër Korrupsionit;
3. Rregullorja nr. 03/2014 për Rregullat dhe Procedurat e Veprimit të Shërbimit të Sigurimit në Objektin e Agjencisë kundër Korrupsionit.

Ligji nr. 04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë, ka pasur ndikim pozitiv në mbarëvajtjen e procesit të deklarimit të pasurisë dhe dhuratave. Në ligj është zgjeruar rrethi i personave të cilët obligohen që të deklarojnë pasurinë, është ulur vlera e pasurisë së luajtshme e cila duhet të deklarohet (nga 5.000 është ulur në 3.000 Euro), është sqaruar periudha e deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë, është përcaktuar vlera e dhuratave të rastit, është precizuar procedura e kontrollit të pasurisë dhe përqindja minimale që duhet t'i nënshtrohet këtij kontrolli, etj.

Gjithashtu, nxjerrja e akteve nënligjore gjatë periudhës raportuese e ka ndihmuar punën e Agjencisë dhe i ka precizuar dizpozitat e kornizës ligjore.

Mosmiratimi i Plotësimit dhe Ndryshimit të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, ka vështirësuar përmbushjen e mandatit të Agjencisë në lidhje me parandalimin e rasteve të konfliktit të interesit, bazuar në faktin se gjatë zbatimit të ligjit bazik për parandalimin e konfliktit të interesit në praktikë janë evidentuar shumë paqartësi dhe zbrazëtira të cilat e kanë vështirësuar punën e Agjencisë, theks të veçantë ushtrimi i dy e më shumë pozitive në të njëjtën kohë nga zyrtarët e lartë publik.

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

Agjencia kundër Korrupsionit (AKK) është institucion i pavarur i themeluar në korrik të vitit 2006, ndërsa ka filluar të funksionojë më 12 shkurt të viti 2007. Baza ligjore për themelimin e Agjencisë është Ligji kundër Korrupsionit (2004/34) i cili i kishte përcaktuar përgjegjësitë dhe fushë-veprimtarinë e saj.

Mandati i Agjencisë është i përqendruar në zbulimin dhe hetimin e rasteve korruptive, përpjekjeve për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit si dhe sensibilizimin e opinionit publik me qëllim të ndërtimit të një shoqërie të shëndoshë që bazohet në shtetin e së drejtës.

Kompetencat e Agjencisë janë të përcaktuara në nenin 5 të Ligji nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Legjislacioni aktual kundër korrupsionit, mbi bazën e të cilit AKK edhe i zhvillon aktivitetet e saj parasheh masat kundër korrupsionit brenda fushës së veprimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, veçanërisht në fushën e hetimeve paraprake të korrupsionit, analizimin dhe eliminimin e shkaqeve të korrupsionit, papajtueshmërinë mes mbajtjes së posteve publike dhe kryerjes së aktiviteteve fitimprurëse për personat zyrtar, kufizimet në lidhje me pranimin e dhuratave të lidhura me kryerjen e detyrës zyrtare, mbikëqyrjen e pasurive të tyre si dhe të personave në lidhje të afërt me ta dhe kufizimet në lidhje me subjektet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publik.

Bazuar në kuadrin ligjor AKK për punën e vetë duhet ti raportoj në baza vjetore Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ndërsa ky është raporti i tetë që Agjencia i paraqet Kuvendit, dhe në mënyrë të detajuar i pasqyron aktivitetet dhe iniciativat e ndërmarra gjatë vitit 2014.

Këto aktivitete kanë qenë të përqendruara në:

- Zbatimin e ligjit, ku përfshihen përcjellja e kallëzimeve penale në prokuroritë kompetente, përcjellja e kërkesave për fillimin e procedurës disiplinore për shkeljet e dyshuara administrative, monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit;
- Parandalimin ose eliminimin e shkaqeve të korrupsionit përmes kryerjes së deklaramit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik, publikimi i regjistrave të formularëve të deklaramit të pasurisë nga zyrtarët e lartë publik në faqen zyrtare të AKK-së në internet, parandalimi i konfliktit të interesit dhe regjistrimi i dhuratave të pranuara nga personat zyrtar, si dhe parandalimi i korrupsionit në aktivitetet e Prokurimit Publik;
- Edukimi i zyrtarëve publik dhe qytetarëve mbi kornizën ligjore dhe mekanizmat aktual të cilët merren me luftimin dhe parandalimin e korrupsionit si dhe vetëdijesimi i publikut për luftën kundër korrupsionit në sensin e nxitjes së një bashkëpunimi të fuqishëm mes tij dhe AKK-së.

4. ORGANIZIMI I BRENDSHËM

Organizimi i brendshëm i AKK-së është i rregulluar me anë të Rregullores së Punës së AKK-së dhe Rregullores për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në AKK. Ato përcaktojnë në mënyrë të detajuar procedurat në lidhje me kryerjen e punëve si dhe përgjegjësitë e çdo zyrtari brenda AKK-së.

AKK përbëhet nga Zyra e Drejtorit, Departamentet, Divizionet dhe Zyra për Mbështetje, Bashkëpunim dhe Informim([Aneksi I](#)).

Aktualisht në Agjenci punojnë 40 zyrtar dhe atë:

- Zyra e Drejtorit të AKK-së, 5 zyrtar;
- Departamenti për Luftimin e Korrupsionit, 11 zyrtar;
- Departamenti për Parandalimin e Korrupsionit, 15 zyrtar,
- Divizioni për Punë të Përgjithshme dhe Financa, 5 zyrtar, si dhe
- Zyra për Mbështetje, Bashkëpunim dhe Informim 4 zyrtarë.

Gjatë vitit 2014 struktura organizative e brendshme e Agjencisë kundër Korrupsionit nuk ka pësuar ndryshime.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe Komisioni Disiplinor kanë vazhduar mandatin e tyre nga viti paraprak.

Kapitujt në vijim paraqesin një pasqyrë të plotë të aktiviteteve të kryera nga Agjencia gjatë periudhës një vjeçare të raportimit, 1 janar - 31 dhjetor 2014.

Agjencia është e vendosur në Rr. "Nazim Gafurri", nr. 31, në Prishtinë. Objekti është i vjetër por në masë të madhe i plotëson nevojat për punë, për një personel prej 40 vetash.

5. AKTIVITETET PËR PERIUdhËN RAPORTUESE

Ky raport vjetor që mbulon periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2014, i cili i adresohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, është i teti me radhë. I ndarë në disa kapituj raporti pasqyron në detaje të gjitha aktivitetet dhe iniciativat e ndërmarra nga Agjencia për këtë periudhë kohore.

5.1 LUFTIMI I KORRUPSIONIT

Aktivitetet e luftimit të korrupsionit në Agjencinë kundër Korrupsionit, zhvillohen nga Departamenti për Luftimin e Korrupsionit. Në pajtim me mandatin e dhënë me Ligjin nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe me legjislacionin tjetër sekondar, Departamenti për Luftimin e Korrupsionit aktivitetet i zhvillon në këto drejtime; zbatimi i ligjit, monitorimi i zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit kundër korrupsionit, avancimi i kuadrit ligjor dhe vetëdijesimi i publikut.

5.1.1 Zbatimi i ligjit

AKK, gjegjësisht Departamenti për Luftimin e Korrupsionit në aspektin e zbatimit të ligjit, është përgjegjës për këto aktivitete:

- Zhvillimin e hetimeve paraprake lidhur me dyshimet e supozuara për korrupsion në ato raste kur nuk iniciohet procedurë penale nga ndonjë mekanizëm tjetër;
- Përcjelljen e rasteve të hetuara tek prokuroria publike kompetente për procedim penal të mëtutjeshëm, si dhe përcjelljen e kërkesave për fillimin e procedurës disiplinore në lidhje me rastet e dyshuara për shkelje administrative;
- Bashkëpunimin me të gjitha autoritet vendore dhe ndërkombëtare të ngarkuara për zbatimin e ligjit gjatë procedurave hetimore që kryhen nga këto autoritete.

5.1.2 Zhvillimi i hetimeve

Prioritet i Departamentit për Luftimin e Korrupsionit gjatë kësaj periudhe raportuese ka qenë pranimi, inicimi sipas detyrës zyrtare dhe hetimi paraprak i rasteve të dyshuara të korrupsionit. Si rrjedhojë janë hetuar raste të raportuara nga qytetaret, po ashtu edhe raste të cilat janë iniciuar sipas detyrës zyrtare kur AKK ka ardhur deri te informacionet e bazuara për veprime korruptive të mundshme.


Sa i përket rasteve të hetuara me dyshimin për veprime korruptive, si dhe lidhur me vendimet finale gjatë kësaj periudhe raportuese, në vijim do të japim pasqyrën e përgjithshme.

- **Rastet e paraqitura në AKK për vitin 2014**

AKK gjatë vitit raportues nga qytetarët ka pranuar informacione në lidhje me dyshimet për veprime korruptive përmes mënyrave të ndryshme të raportimit. AKK për qytetarët të cilët duan ti raportojnë rastet e dyshuara për korrupsion ka dhënë mundësinë e disa mënyrave të raportimit. Fjala është për raportim të drejtpërdrejtë në AKK, përmes linjës telefonike pa pagesë 0800 10 800, postës dhe përmes e-mailit (formës online) nga www.akk-ks.org. Për personat të cilët me mirëbesim kanë zbuluar informacionin për ekzistencën e korrupsionit dhe me qëllim të pengimit të pasojave të dëmshme ndaj tyre, AKK ka mundësuar që ata ti paraqesin rastet e dyshuara të korrupsionit në mënyrë anonime me qëllim të ruajtjes së identitetit të raportuesve dhe inkurajimin e qytetarëve për raportimin e këtyre rasteve.

Gjatë vitit 2014, AKK ka zhvilluar procedurën e hetimeve paraprake në gjithsejtë 304 raste, prej të cilave 56 prej tyre janë bartur nga vitet paraprake, kurse gjatë vitit 2014 janë pranuar edhe 248 raste. Prej tyre 131 raste, janë përcjell në Prokurori dhe Polici për procedim të mëtutjeshëm, 11 raste janë përcjell në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore, 4 raste janë deleguar në kompetencë të organeve respektive, 102 raste janë mbyllur, ndërsa 56 raste janë në procedurë. Numri i përgjithshëm i informacioneve anonime të trajtuara është 37. Gjatë vitit raportues Agjencia ka trajtuar gjithsejtë **124** raste të iniciuara sipas detyrës zyrtare (ex-officio).

Rastet në procedurë të gjitha janë raste të regjistruara gjatë vitit 2014. Grafiku i mëposhtëm pasqyron procedimin e 304 rasteve të trajtuara gjatë vitit 2014.



Grafiku 1. Pasqyrimi i procedimit të rasteve të trajtuara gjatë vitit 2014

- **Rastet e përcjella në institucionet kompetente për procedim të mëtutjeshëm**

Gjatë periudhës raportuese në institucionet kompetente për procedim të mëtutjeshëm janë përcjell **131** informata dhe kallëzime penale.

Prej tyre në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit janë përcjellë **121** kallëzime penale, për të cilat Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka njoftuar se ato janë deleguar në kompetencë të prokurorive respektive. Përderisa në Drejtorinë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion/Policia e Kosovës, janë përcjell **10** informata.


Ndërsa, në njëmbëdhjetë (11) raste pas përfundimit të procedurave hetimore paraprake është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim të arsyeshëm se rasti mund të përbëjë vepër penale, por është dyshuar për shkelje administrative, dhe Agjencia këto raste i ka përcjell në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore.

Gjithashtu, në 4 raste është konstatuar mungesa e kompetencës së AKK-së, andaj të njëjtat janë deleguar në kompetencë të organeve respektive.

Vlera e dëmit të shkaktuar sipas rasteve të përcjella në Prokuroritë kompetente dhe Polici nga rasti në rast supozohet të jetë nga 500.00 euro – 1, 276, 000. 00 euro.

- **Personat e dyshuar për veprime korruptive**

AKK, në 131 rastet e përcjella në prokuroritë publike dhe organet policore kompetente për procedim të mëtutjeshëm penal pas konstatimeve se ka të dhëna të mjaftueshme apo/ dhe dyshim të arsyeshëm për përfshirjen në veprime korruptive, ka denoncuar 163 persona. Prej tyre 158 persona janë përcjell në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe 5 persona në DHKEK- Policia e Kosovës. Në 8 raste të përcjella në DHKEK- Policia e Kosovës nuk është arritur identifikimi i personave. Këto të dhëna janë pasqyruar në grafikun e më poshtëm.



Grafiku 2. Pasqyrimi i Kallëzimeve Penale dhe numrit të personave të përfshirë të përcjella në institucionet përkatëse

AKK gjithashtu gjatë periudhës raportuese ka përcjellë 11 raste në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore kundër 23 personave zyrtarë të institucioneve të Republikës së Kosovës. Ndërsa për 4 rastet të deleguara në kompetencë të organeve respektive janë përcjellë 4 persona.

- **Rastet e përcjella sipas strukturës së veprave penale**

Në mesin e 131 rasteve të përcjella në Prokurori dhe DHKEK- Policia e Kosovës për procedim të mëtutjeshëm, në disa prej tyre janë të përfshira dy e më shumë vepra penale. Veprat penale i përkasin kryesisht kapitullit XXXIV Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare sipas Kodit Penal të Kosovës, mirëpo nuk përjashtohen rastet kur janë përcjell me dyshime për veprime të sanksionuara në kapitujt tjerë sipas Kodit Penal të Kosovës. Ndërsa, në 9 raste, për veprimet e dyshuara nuk është arritur që të kualifikohen se çfarë figure të veprës penale paraqesin, për shkak të tejkalimit të mundësive hetimore të Agjencisë.

- **Struktura e veprave penale të përcjella në institucionet kompetente**

Struktura e veprave penale të përcjella në institucionet kompetente dhe niveli i zyrtarëve të dyshuar, është si në vijim:

Keqpërdorimi i Pozitës apo autoritetit zyrtar - Nga numri i përgjithshëm i rasteve të përcjella në Prokuroritë dhe DHKEK- Policia e Kosovës numrin e dytë më të madh të tyre e përbejnë veprimet korruptive të parapara sipas nenit 422 të KPK-së. Sipas figurës së veprës penale në fjalë janë përcjellë 19 informata dhe kallëzime penale të kësaj natyre. Në disa raste kjo vepër penale shoqërohet edhe me vepra tjera penale si **Ushtrim i ndikimit** (neni 431 të Kodit Penal të Kosovës), **Mashtrimi në detyrë** (neni 426 të Kodit Penal të Kosovës), **Punimet ndërtimore të kundërligjshme** (neni 368 të Kodit Penal të Kosovës), **Veprimtaria e pandërgjegjshme ekonomike** (neni 285 të Kodit Penal të Kosovës). Personat e përfshirë në këto raste janë nga nivele të ndryshme: ish Deputet i Kuvendit të Kosovës, ish Kryetar Komune, ish Rektorë, Sekretarë dhe Drejtor Prokurimi në Universitetin Publik, anëtarë dhe ish anëtarë të Bordit të Institucionit të Pavarur, ish Kryeshef Ekzekutiv të Ndërmarrjes Publik niveli qendror, Drejtor, Menaxher dhe Kryesues Sektori të njësisë organizative në kuadër të Ndërmarrjes Publike niveli qendror, Menaxher Prokurimi të institucionit në kuadër të Ministrisë, Drejtor Departamentesh në Ministri, Drejtor dhe ish Drejtorë të Drejtorive komunale, Menaxher dhe ish Menaxher Prokurimi komunal, Avokat i Komunës, anëtarë komisionesh vlerësimi të aktiviteteve të prokurimit, anëtarë komisionesh për vlerësim të kandidatëve, zyrtarë nga nivele tjera, përfaqësues të OE dhe investitorë privat. Sipas institucioneve kjo vepër penale në 7 raste është kryer nga zyrtarët e institucioneve tjera, 7 raste nga zyrtarët e pushtetit lokal dhe 5 raste nga zyrtarët e institucioneve në kuadër të Qeverisë.

Përvetësimi në detyrë – sipas përcaktimit të kësaj vepre penale nga neni 425 të Kodit Penal të Kosovës 1 rast është përcjellë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit kundër Drejtorit të shkollës së mesme dhe sipas institucioneve i përket pushtetit lokal.

Marrja e Ryshfetit - sipas përcaktimit të kësaj vepre penale nga neni 428 të Kodit Penal të Kosovës 1 rast është përcjellë në DHKEK- Policia e Kosovës, kundër stafit mjekësor dhe sipas institucioneve i përket pushtetit lokal. Në këtë rast kjo vepër është shoqëruar edhe me veprën penale Dhënia e Ryshfetit (neni 429 të Kodit Penal të Kosovës).

Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare - Numrin më të madh të rasteve të përcjella në prokurori e përbëjnë veprimet e sanksionuara sipas nenit 437 të Kodit Penal të Kosovës, gjithsejtë 101 kallëzime penale.

Prej tyre 93 raste janë përcjell për mos raportim të pasurisë të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër materiale ose të detyrimeve financiare nga paragrafi 1 i nenit 437 të KPK-së.

Rastet e përcjella për mos raportim sipas llojeve të deklarimit të pasurisë ndahen në:

Dy (2) për mos deklarim të rregullt vjetor nga zyrtarë i lartë financiar në institucion të pavarur dhe Këshilltar i Asamblesë Komunale;

Dyzetenjë (41) për mos deklarim me rastin e marrjes së detyrës nga Kryetar Komunash, Kryesues të Asambleve Komunale dhe Këshilltar të Asambleve Komunale;

Pesëdhjetë (50) për mos deklarim pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni nga ish Kryetar Komunash, ish Këshilltar të Asambleve Komunale dhe ish Drejtorë të Drejtorive Komunale.

Sipas institucioneve kjo vepër penale (paragrafi 1) në 92 raste është kryer nga zyrtarët e pushtetit lokal dhe në 1 rast nga zyrtari i institucioneve tjera.

Me dyshimin për raportim të rremë të pasurisë, të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër materiale ose të detyrimeve financiare, nga paragrafi 2 i nenit 437 të KPK-së janë përcjell 8 raste. Prej tyre 4 deklarim i rremë i të hyrave vjetore nga stafi diplomatik- Ambasador dhe Këshilltarë, Menaxher i Ndërmarrjes nën menaxhim të AKP-së, Drejtor i Departamentit në Ministri, 3 mos deklarim i zotërimit të aksioneve në shoqëri tregtare nga Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë Ekzekutive në kuadër të Ministrisë, Drejtor i Njësisë së Auditimit në Ministri dhe Auditor i Brendshëm i Ndërmarrjes Publike Komunale, si dhe 1 mos deklarim i paluajtshmërisë nga Këshilltarë Politik në Ministri.

Sipas institucioneve kjo vepër penale (paragrafi 2) në 6 raste është kryer nga zyrtarët e institucioneve në kuadër të Qeverisë, 1 nga zyrtarët e pushtetit lokal dhe 1 rast nga zyrtari i institucioneve tjera.

- **Karakteristikat e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimeve paraprake**

AKK ka zhvilluar procedurën e hetimeve paraprake në lidhje me dyshimet për veprime korruptive, pra në lidhje me veprat penale nga kapitulli XXXIV i KPK-së - Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare. Përkundër një angazhimi të përgjithshëm institucional veprat penale të korrupsionit vazhdojnë të përbëjnë numrin më të vogël të veprave të hetuara nga organet e ndjekjes, por njëkohësisht përbëjnë edhe veprat penale për të cilat më së paku janë shqiptuar dënime.

Karakteristikë e rasteve të hetuara që kanë të bëjnë me veprën penale **Keqpërdorim i Pozitës apo autoritetit zyrtar** nga neni 422 të KPK-së, është shfrytëzimi i detyrës apo autoritetit zyrtar nga personi zyrtar i cili me veprim apo mosveprim shkel ligjet e aplikueshme me qëllim përfitimi të çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër, apo me qëllim të shkakimit të dëmit për personat tjerë apo biznesin e caktuar, ose që seriozisht shkel të drejtat e personit tjetër, tejkalon kompetencat dhe nuk i përmbush detyrat zyrtare.

Gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit, veprimet apo mos veprimet e përmendura, i referohen shkeljes së procedurave të prokurimit, apo në rastet më të këqija anashkalimi i tërësishëm i këtyre procedurave duke iu shmangur në këtë mënyrë transparencës dhe konkurrencës lojale. Shkeljet e procedurave të prokurimit paraqiten gjatë gjithë ciklit të prokurimit duke filluar nga planifikimi dhe përgatitja e dosjeve të tenderëve si:

- ✓ Hartimi i dosjeve të tenderëve në kundërshtim me ligjin dhe rregulloren për prokurim publik;
- ✓ Caktimi i kundërligjshëm i kriterëve të përzgjedhjes me qëllim favorizimi të OE të caktuar;
- ✓ Lejimi i vazhdimit të proceduarave të prokurimit dhe pse të njëjtat janë përcjell me shkelje të ligjit të prokurimit;
- ✓ Në planifikimin e prokurimit i cili parashihet si projekt me bashkëfinancim, përgatitet dhe nënshkruhet “Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve” në vlerë të parashikuar, edhe pse nuk ka pasur mjete financiare të mjaftueshme në dispozicion për këtë aktivitet prokurimi në vlerën e paraparë të tij.

Në fazën e vlerësimit të ofertave paraqiten shkelje si:

- ✓ Rekomandimi për dhënien e kontratës OE të papërgjegjshëm, i cili me çmimin më të lirë renditet i 7 (shtati) prej OE, duke i mundësuar të njëjtit përfitim të kundërligjshëm në vlerën të ndryshme mes operatorit tjetër ekonomik të përgjegjshëm me çmim më të ultë, përkatësisht i cili ka qenë më i lirë, edhe se OE tjerë në vijim me çmime më të ulëta sesa OE fitues;
- ✓ Nënshkrimi i kontratës me OE në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik, edhe pse procedura e prokurimit është dashur që të anulohet në mungesë të dy ofertave të përgjegjshme, sepse vetëm OE fitues ka qenë i përgjegjshëm, përderisa për këtë aktivitet prokurimi kanë ofertuar vetëm tre OE, dhe rekomandimi i komisionit të vlerësimit ka qenë për anulimin e kësaj procedure të prokurimit;
- ✓ Shpërblimi me kontratë OE duke ditur se i njëjti ka manipuluar me çmimet e ofruara për artikujt e caktuar sepse ka pasur informata se nuk janë shfrytëzuar vitin e kaluar, ngase ka qenë i kontraktuar nga AK, i cili kishte ofruar çmime jo normalisht të ulëta, të cilat çmime kanë ndikuar që të shpallet si ofertuesi më i mirë dhe i njëjti të shpallet edhe fitues i kontratës, për aktivitetin e caktuar të prokurimit;
- ✓ Shpërblimi me kontratë OE i cili kishte ofertuar me çmimin më të lirë edhe pse duke e ditur se i njëjti OE, kishte manipuluar me çmimet e ofruara për disa pjesë të caktuara të pajisjeve në aktivitetin e prokurimit pasi që i posedonte informatat lidhur me gjendjen e pajisjeve nga kontrata paraprake;
- ✓ Nënshkrimi i kontratës vetëm me mjetet të cilat ishin mbledhur nga banorët në projekt bashkëfinancimi, e jo me zotimin e mjeteve të mjaftueshme financiare për përmbushjen e detyrimeve që kishin dalë dhe mund të dilnin si rezultat i kontratës, dhe pa u bërë sigurimi i ekzekutimit të kontratës në vlerë prej 10% të vlerës së kontratës, por duke u marrë vesh me OE fitues, që depozitimi i sigurisë së ekzekutimit të bëhet me situacione varësisht nga zotimi i mjeteve.

Faza e mbikëqyrjes së realizimit të punëve, ofrimit të shërbimeve dhe furnizimit karakterizohet si:

- ✓ Mbikëqyrësi mbi ekzekutimin e punëve në lidhje me riparimin e tërësishëm të objektit të caktuar pa aprovimin e Zyrtarit Kryesor Administrativ dhe pa njoftuar Menaxherin e Prokurimit, në kundërshtim me dosjen e tenderit të përgatitur nga Autoriteti Kontraktues si dhe në kundërshtim me kontratën kishte lejuar që të ndryshohet para masa dhe para llogaria, ku kërkohet furnizimi me material dhe montimi i materialit të caktuar me material tjetër duke hequr nga para masa dhe para llogaria furnizimin me material dhe montimin e kërkuar;

- ✓ Përkundër vonesave në dorëzimin e mallit/shërbimeve të AK apo përfundimin e punimeve, nuk ndërmerren masa ndëshkuese për likuidimin e dëmeve (shqiptim i penaltive), duke e dëmtuar kështu buxhetin e institucionit, edhe pse kriteri dorëzimi i mallit (afati i liferimit) apo afati për përfundimin e punimeve sipas dosjes së tenderit e ka radhitur OE fitues në pozitën e parë;
- ✓ Në kundërshtim me dispozitën e veçantë të kontratës së nënshkruar në mes të AK dhe OE, personi zyrtar nga AK nuk ka raportuar për vonesat e OE në kryerjen e punëve konform planit dinamik dhe kontratës së lartcekur, duke ndikuar që të metat e likuiduara të mos realizohen nga AK, ngase i njëjti në kohën kur e ka menaxhuar kontratën e lartcekur, ka qenë i punësuar edhe në OE, gjendje kjo që paraqet edhe konflikt të interesit e sipas nenit 5 të Kodit Etik të Prokurimit të vitit 2007 do duhej ta deklaronte dhe shmangte.

Vepra penale Keqpërdorim i Pozitës apo autoritetit zyrtar i karakterizon edhe rastet e hetuara për shkelje të tjera si:

- ✓ Ish zyrtari i lartë publik në cilësi të udhëheqësit të organit më të lartë në vijën hierarkike institucionale përmes shkresës i kërkon udhëheqësit të institucionit vartës që gjatë formimit të komisionit të caktuar për përzgjedhje të kandidatëve për pozita të caktuara, të ketë parasysh përbërjen e komisionit me qëllim ndryshimin e përbërjes së komisionit të caktuar herën e parë, ashtu që komisioni i ndryshuar të veprojë kundërligjshëm, edhe pse përbërja e komisionit të parë konsiderohet kompetente për përzgjedhje të kandidatëve sipas konkursit;
- ✓ Pranimi i investimeve dhe lirimi nga kushtet e marrëveshjes sipas kërkesës së blerësit, edhe pse vlerësimet respektive kishin konstatuar mos përmbushje të kushteve të marrëveshjes dhe investime jo përkatëse;
- ✓ Bartja e njehsorit të shërbimit të caktuar publik nga pronari i shtëpisë (ku ishte vendosur njehsori), të qiramarrësi, pa dokumentacion apo bazë ligjore dhe pa pëlqim të këtij të fundit, ku si pasojë e borxhit të shkaktuar nga qiramarrësi pronari ka pësuar me ç' kyçje nga shërbimi për një periudhë të caktuar kohore;
- ✓ Mungesa e gatishmërisë për të ri verifikuar gjendjen reale në teren duke u pamundësuar dhe mohuar përfituesve të mundshëm përfitimin e mbështetjes financiare për periudha të caktuara kohore lidhur me projekte të cilat mbështeten për veprimtari të caktuara, edhe pse i plotësojnë kushtet e përcaktuara;
- ✓ Përmbushja e përqindjes së konsiderueshme të punëve të parapara në projekt për të cilin zhvillohet aktiviteti i prokurimit duke shfrytëzuar kontrata tjera dhe kërkimi nga zyra e prokurimit për ndërprerjen e procesit të tenderit në fjalë, për shkak se është bërë zgjidhje e përkohshme;
- ✓ Mos ndërmarrja e veprimeve konkrete për rrënimin e objektit shumë banesor me afarizëm të ndërtuar në kundërshtim me ligjin dhe kushtet ndërtimore si dhe pa leje ndërtimore nga investitori;
- ✓ Dhënia e pëlqimit parashtrueses së kërkesës që ti kthehet pjesa e mbetur e pashfrytëzuar e paluajtshmerisë së marrë nga posedimi nga pronari i mëparshëm për nevoja të caktuara të përgjithshme;
- ✓ Aprovimi i kërkesës për kthimin e pjesës së mbetur të pashfrytëzuar të paluajtshmerisë së marrë nga posedimi nga pronari i mëparshëm për nevoja të caktuara të përgjithshme.

Disa veprime tjera të cilat e karakterizojnë këtë vepër penale për shkak të natyrës së tyre nuk janë prezantuar për faktin se publikimi i tyre do të mund të dëmtonte procesin e mëtutjeshëm të hetimeve.

Përvetësimi në detyrë - sipas përcaktimit të kësaj vepre penale nga neni 425 të Kodit Penal të Kosovës është dyshuar personi zyrtar i cili ka përvetësuar shumë më të madhe të mjeteve të realizuara vetanake (të holla) sesa i lejohej me rregulloret përkatëse.

Mashtrimi në detyrë - sipas nenit 426 të KPK-së, të rastet e hetuara është karakterizuar me prezantimin e rremë të raporteve mbi përfundimin e punimeve/furnizimit/shërbimit në lidhje me projekte të caktuara, ashtu që kinse punimet/furnizimi/shërbimi janë realizuar sipas kontratës dhe prezantimin e rremë të raporteve të pranimit duke vënë në lajthim personat e autorizuar për kryerjen e pagesave, edhe pse punimet/furnizimi/shërbimi nuk ishin realizuar sipas kontratës me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për punë kryesin/furnizuesin apo ofruesin e shërbimit.

Marria e Ryshfetit - sipas përcaktimit të kësaj vepre penale nga neni 428 të Kodit Penal të Kosovës dhe **Dhënia e Ryshfetit** nga neni 429 të Kodit Penal të Kosovës, të cilat sipas Kodit Penal janë vepra të ndara penale, e karakterizojnë rastin e dyshuar ku është paguar shuma e caktuar e mjeteve monetare në këmbim të realizimit të ndonjë favorit/përparësie.

Ushtrim i ndikimit - sipas nenit 431 të KPK-së karakterizohet me ushtrimin e ndikimit të padrejtë nga ana e personit të caktuar zyrtarë mbi vendimmarrjen e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të aktivitetit për angazhim të caktuar edhe pse nuk i ka plotësuar kushtet/kriteret sipas rregullativës ligjore, të cilës i janë referuar kushtet dhe kriteret e angazhimit, ashtu që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të pranon ndonjë përfitim për vete.

Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare -nga neni 437 të KPK-së, është vepër penale e re e cila është përcaktuar në Kodin Penal të Kosovës i cili ka hyrë në fuqi nga 01 Janar 2013. Karakteristikë e rasteve të hetuara të cilat kanë të bëjnë me këtë vepër penale është mos deklarimi i pasurisë brenda afateve të përcaktuara kohore sipas ligjit në fuqi (sipas deklarimit të rregullt vjetor, deklarimit me marrjen e detyrës, deklarimi pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni dhe sipas kërkesës së AKK-së) dhe mos paraqitja e të dhënave të kërkuara si paluajtshmëria, pasuria e luajtshme në vlerë mbi pesëmijë (5 000) Euro, zotërimi i aksioneve në shoqëri tregtare, letrave me vlerë, para të kursyera në bankë dhe në institucione tjera financiare, detyrime financiare ndaj personave fizik dhe juridik dhe të hyrave vjetore, si dhe falsifikimi apo raportimi i rremë i tyre.

Punimet ndërtimore të kundërligjshme - sipas nenit 368 të Kodit Penal të Kosovës, është karakteristikë të rastet e hetuara për veprime në kundërshtim me Ligjin për Ndërtim dhe rregullativën tjetër ligjore, rreth ndërtimit të objektit afarist pa leje ndërtimore dhe në kundërshtim me kushtet ndërtimore ashtu që është rrezikuar jeta apo trupi i njerëzve ose i pasurisë së fqinjëve.


Veprimtaria e pandërgjegjshme ekonomike - sipas nenit 285 të Kodit Penal të Kosovës i karakterizon rastet e hetuara kur në aktivitete të prokurimit OE kanë ofruar çmime jashtëzakonisht të ulëta duke marr parasysh çmimet e tregut të jashtëm për pajisje të ngjashme, si dhe për pjesët e pajisjeve për të cilat nuk ishin në përdorim, pasi që i posedonte informatat lidhur me gjendjen e pajisjeve nga kontrata paraprake, ofron çmime ekstrem të ulëta, duke ndikuar kështu në çmimin total i cili rezulton të jetë më i ulëti, ashtu që ka vepruar në kundërshtim me standardet e rregullta të afarizmit.

- **Rastet e përcjella sipas vitit të kryerjes së veprimit të dyshuar korruptiv**

Në periudhën raportuese, rastet për të cilat gjatë hetimeve AKK ka gjetur prova për vërtetimin e dyshimeve për veprime korruptive e të cilat janë përcjell për procedim penal të mëtutjeshëm në institucionet kompetente, i takojnë viteve të ndryshme të kryerjes së tyre, duke filluar nga viti 2006-2014.

- **Numri i rasteve të përcjella që nga funksionalizimi i AKK-së**

AKK që nga funksionalizimi e deri në momentin e raportimit, nga të gjitha rastet e hetuara ku janë gjetur prova për vërtetimin e dyshimeve për veprime korruptive, i ka përcjell në prokuroritë kompetente, prokurorinë e EULEX-it, Policinë e Kosovës, Inspektoratin Policor të Kosovës dhe Njësinë e Hetimeve Financiare, gjithsejtë 552 raste. Në vitin 2007 AKK në Institucionet Kompetente ka përcjellë 47 raste në të cilat kanë qenë të përfshirë 91 persona, në vitin 2008 ka përcjellë gjithsejtë 53 raste në të cilat kanë qenë të përfshirë 113 persona, në vitin 2009 AKK ka përcjellë 68 raste ku janë të përfshirë 159 persona, në vitin 2010 ka përcjellë 33 raste, ndërkaj janë të përfshirë 164 persona, në vitin 2011 ka përcjellë 39 raste të përfshirë 121 persona, në vitin 2012 janë përcjellë gjithsejtë 52 raste me përfshirje të 159 personave, në vitin 2013 janë përcjellë gjithsejtë 128 raste kundër 238 personave. Ndërsa, në vitin 2014 janë përcjell gjithsejtë 131 raste kundër 163 personave.



Grafiku 3. Numri i rasteve të përcjella në organet kompetente si dhe personat e përfshirë (2007- 2014)

Nga numri i përgjithshëm i rasteve të përcjella nga viti 2007 deri 2014 në Prokuroritë Kompetente dhe Policinë e Kosovës, prokuroritë dhe institucionet tjera kanë dhënë informacion kthyes duke konfirmuar se 295 raste janë në procedurë hetimore, janë ngritur 47 aktakuza/ propozim akuza dhe ka filluar procesi gjyqësorë, 124 raste është konfirmuar se janë hedhur poshtë/pushuar hetimet, ndërsa për 67 raste të përcjella nuk ka informata kthyesë. Një rast është vendosur edhe në Gjykatën e Apelit.

Në mënyrë tabelare, këto të dhëna duken kështu:

Nr.	Institucioni	Lëndët e përcjella	Hetime	Aktakuza/ Propozim akuza/ Proces gjyqësorë	Vendime Gjyqësore	Lëndë të hedhura/ pushuara	Pa informata kthyesë
1	PSH	13	10	-		-	3
2	PSRK	27	19	1		5	2
3	P. e EULEX-it	45	7	-		24	14
4	PTH. Prishtinë	278	199	21		48	2
5	PTH. Prizren	27	-	8		15	-
6	PTH. Pejë	19	5	3		11	-
7	PTH. Mitrovicë	8	3	1		4	-
8	PTH. Gjilan	37	22	4		9	-
12	PTH. Gjakovë	15	-	8		3	-
15	PTH. Ferizaj	12	7	1		4	-
16	Policia e Kosovës	60	22	-		-	38
17	IP	4	-	-		1	3
18	FIU	6	1	-		-	5
19	GJ. e Apelit				1		
20	GHTH Prishtinë				8		
21	GTH Prizren				4		
22	GTH Gjilan				2		
23	GHT Gjakovë				4		
Gjithsej:		551	295	47	18	124	67

Tabela 1. Rastet e përcjella nëpër organet kompetente që nga funksionalizimi i AKK-së

Nga gjithsejtë 551 rastet e përcjella në Institucionet kompetente për procedim të mëtutjeshëm penal numri i personave të dyshuar është: **1208** persona të identifikuar, ku në 47 prej këtyre rasteve AKK nuk ka arritur që të identifikoj personat konkret.

Në rastet për të cilët janë ngritur propozim akuza dhe aktakuza nga ana e Prokurorive kompetente, si dhe është duke u zhvilluar proces gjyqësorë janë të përfshirë gjithsejtë 68 persona.

Gjatë periudhës raportuese ka pasur lëvizje progresive sa i përket aspektit të gjyqimit të rasteve të dyshuara për korrupsion sipas aktakuzave të ngritura nga Prokuroritë kompetente mbi bazën e kallëzimeve penale të AKK-së. Për disa nga rastet e përcjella ka filluar procesi gjyqësorë, përkatësisht 37 raste, ku prej tyre 19 raste vazhdon procesi gjyqësorë dhe për 18 raste janë nxjerr edhe vendime gjyqësore. Kryesisht proceset gjyqësore kanë trajtuar aktakuzat e ngritura për veprën penale Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 437 të KPK-së.

- **Mënyra e hedhjes poshtë të rasteve nga Prokurorit/ pushimi i hetimeve**

Trendi i hedhjes poshtë të rasteve të përcjella nga AKK prej Prokurorive apo pushimit të hetimeve ka vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe raportuese.

Vlerësimi i kësaj situatë mbi bazën e informacioneve të pranura nga Prokuroritë ka konfirmuar arsyet e raportuara në Raportin vjetor të punës së AKK-së për vitin 2013 rreth mënyrës së hedhjes poshtë të rasteve nga prokuroritë.

Prokurorët kanë vazhduar se kërkuesi nga AKK që të provojë qëllimin e veprave penale si element konstituiv i figurës së tyre, përderisa në asnjë rast edhe përkundër mundësive ligjore të njëjtat nuk kanë ndërmarr veprime hetimore të nevojshme dhe nuk kanë arritur që të provojnë vet qëllimin.

Në shumicën e arsyetimeve të rasteve të hedhura poshtë, prokuroritë kompetente theksojnë se dyshimet e AKK për kryerje të veprave penale me natyrë korruptive nuk paraqesin vepra penale por të njëjtat konsiderohen dhe konstatohen shkelje administrative. Andaj duke i konsideruar si të tilla pushohen hetimet duke pamundësuar hetimet e mëtutjeshme për dyshimet e ngritura nga AKK. Tek disa raste të ngritura me kallëzime penale nga AKK, skadon afati i ndjekjes penale apo është bërë parashkrimi i ndjekjes së veprave penale për shkak të neglizhencës së Prokurorive Kompetente. Po ashtu, në disa raste Prokuroritë Kompetente injorojnë provat e paraqitura së bashku me kallëzimet penale nga ana e AKK-së.

Prokuroritë në shumicën e rasteve hedhjen poshtë të rasteve apo pushimin e hetimeve e kanë mbështetur kryesisht në raportet e veçanta të ofruara nga Policia e Kosovës. Në shumicën e rasteve kur Prokuroritë kanë hedhur poshtë apo kur kanë pushuar hetimet, sipas arsyetimit mund të nxirret si konkludim se njohuritë e Prokurorëve rreth Ligjit të Prokurimit janë bazike dhe shkeljet e tij nuk trajtohen drejtë, ngase dëmi i shkaktuar si pasojë e këtyre shkeljeve mbetet i pa sanksionuar.

Ekspertizat të cilave Prokuroritë ia falin besimin në rastet e dyshuara për shkelje gjatë procedurave të prokurimit publik, e të cilat megjithëse konstatojnë shkelje, i arsyetojnë ato se kontratat fitohen nga OE të cilët ofertojnë me çmime më të lira, pa vlerësuar cilësinë e në disa raste edhe sasinë e ofruar për punët, shërbimet dhe furnizimet e kontraktuara.

Janë vërejtur raste kur brenda prokurorisë informacioni i njëjtë trajtohet nga dy prokurorë ndaras.

Gjatë pranimi të informatave kthyesë lidhur me rastet e AKK-së të përcjella në Prokuroritë kompetente jemi informuar se në të paktën një rast pas hedhjes poshtë dhe mbylljes me arsyetimin për parashkrim, nga i njëjti prokuror rasti është rikthyer pas dy viteve në hetime përsëri duke përfunduar me ngritje të aktakuzës. Në disa raste Prokurorët e lëndëve janë tërhequr nga aktakuzat e tyre të ngritura gjatë procedurës gjyqësorë.

- **Aspekte rreth trajtimit të rasteve në Gjykatë**

Nga informacionet e pranura nga Gjykatat respektive lidhur me rastet e dyshuara për korrupsion sipas aktakuzave të ngritura nga Prokuroritë kompetente mbi bazën e kallëzimeve penale të AKK-së, jemi njoftuar lidhur me vendimet e tyre se për 18 aktakuza janë nxjerr 12 Aktgjykime dënuese kundër 12 personave, 2 aktgjykime lirues, 2 Aktvendime për hedhje poshtë dhe 2 Aktgjykime refuzuese. Në një rast Gjykata e Apelit ka refuzuar ankesën e të akuzuarës dhe ka vërtetuar Aktgjykim dënues të Gjykatës Themelore në Gjakovë.

Në mënyrë tabelore këto të dhëna sipas Gjykatave duken kështu:

Nr.	Institucioni	Aktgjykim dënues	Aktgjykim lirues	Aktvendim për hedhje poshtë	Aktgjykim refuzues
1	GJTH. Prishtinë	6	1	-	1
2	GJTH. Prizren	1	1	1	1
3	GJTH. Gjilan	1	-	1	-
4	GJTH. Gjakovë	4	-	-	-
Gjithsejtë:		12	2	2	2

Tabela 2. Vendimet e Gjykatave sipas Nenit 437 të KPK

Me Aktgjykime dënuese Gjykatat kanë shqiptuar dënime komulative me gjobë dhe burgim. Dënimet me gjobë janë shqiptuar në shumë prej 150 euro deri në 1000 euro, ndërsa dënimet me burg në kohëzgjatje prej 2 muajve deri në 6 muaj. Dënimet me gjobë është caktuar që të paguhen kryesisht pas plotfuqishmërisë së aktgjykimeve dhe në disa raste me këste prej 4 deri në 7 këste, me mundësinë e revokimit në dënim me burg, ku 20 euro do të llogaritet me një ditë burgimi në rast se i akuzuari nuk e paguan atë dhe e njëjta nuk mund të ekzekutohet me detyrim. Dënimet me burgim Gjykatat i kanë shqiptuar si dënime me kusht duke urdhëruar që ato mos të ekzekutohen nëse të dënuarit nuk kryejnë vepër tjetër penale për kohën e verifikimit kryesisht në afat prej 1 viti, apo i kanë shndërruar në dënime me gjobë.

Në mënyrë tabelare të dhënat e Aktgjykimeve dënuese sipas Gjykatave duken kështu:

Nr.	Institucioni	Aktgjykim dënues me burgim	Aktgjykim dënues me gjobë
1	GJTH. Prishtinë	2 muaj i shndërruar në dënimin me gjobë 1200 euro	200 euro
2	GJTH. Prishtinë	4 muaj me kusht	1000 euro
3	GJTH. Prishtinë	6 muaj me kusht	500 euro
4	GJTH. Prishtinë	2 muaj me kusht	1000 euro
5	GJTH. Prishtinë	3 muaj me kusht	500 euro
6	GJTH. Prishtinë	2 muaj i shndërruar në dënimin me gjobë 1200 euro	200 euro
7	GJTH. Prizren	6 muaj me kusht	400 euro
8	GJTH. Gjakovë	3 muaj me kusht	
9	GJTH. Gjakovë	3 muaj me kusht	
10	GJTH. Gjakovë	3 muaj me kusht	300 euro
11	GJTH. Gjakovë	3 muaj me kusht	200 euro
12	GJTH. Gjilan	4 muaj me kusht	1000 euro

Tabela 3. Aktgjykimet dënuese nga gjykatat sipas nenit 437 të KPK

Dënimet e shqiptuara i referohen veprës penale nga neni 437 të Kodit Penal të Kosovës, ku 8 raste janë për mos deklarim të rregullte vjetor të pasurisë, 2 rast për mos deklarim pas mbarimit nga funksioni dhe 2 raste për deklarim të rremë të pasurisë apo mos paraqitje të të dhënave të kërkuara në deklaratë, përkatësisht njëri për mos paraqitje të biznesit (zotërimit të aksioneve në shoqëri tregtare) dhe njëri për mos paraqitje të saktë të të hyrave vjetore.

Me Aktgjykime lirues në një rast Gjykata ka liruar nga akuza të akuzuarin për mos paraqitje të biznesit dhe në rastin tjetër për mos paraqitje të saktë të të hyrave vjetore.

Aktvendim për hedhje poshtë është nxjerr në një rast për veprën penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 të KPPK-së për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale dhe është pushuar procedura, dhe në një rast për mos deklarim të rregullt vjetor të pasurisë me arsyetimin se nuk ka prova të mjaftueshme për dyshim të bazuar për veprën penale.

Aktgjykim refuzues është nxjerr në një rast për veprën penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 të KPPK-së dhe në një rast për mos paraqitje të saktë të të hyrave vjetore për shkak se prokurori është tërhequr nga akuza gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Rastet e mbyllura

Gjatë kësaj periudhe raportuese AKK pas zhvillimit të procedurave hetimore paraprahe ka mbyllur 102 raste. Arsyet për mbylljen e tyre janë si vijon:

- ✓ 65 raste janë mbyllur për shkak se pas zhvillimit të procedurës së hetimeve paraprahe është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim të bazuar se rasti mund të përbëjë vepër penale apo shkelje administrative;
- ✓ 22 raste janë mbyllur në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, për shkak se Agjencia nuk ka pas kompetencën për zhvillimin e procedurës së hetimeve paraprahe; dhe
- ✓ 15 raste janë mbyllur për shkak se ka qenë duke u zhvilluar procedurë penale nga organet kompetente, ku prej tyre 5 raste nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, 4 raste nga DHKEK Policia e Kosovës, 2 raste nga Prokuroria Themelore në Pejë, 1 rast nga Prokuroria e Shtetit, 1 nga Prokuroria Speciale e Kosovës, 1 rast nga Prokuroria Themelore në Gjiilan dhe 1 rast nga Njësia për Hetimin e Krimin të Organizuar- EULEX-it.

5.1.3 Bashkëpunimi me institucionet tjera që kanë për mision luftimin dhe parandalimin e korrupsionit

Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese Agjencia i ka kushtuar vëmendje të veçantë angazhimit për avancimin e bashkëpunimit të ndërsjellët me institucionet vendore dhe ndërkombëtare të cilat për mision kanë luftimin dhe parandalimin e korrupsionit. Megjithatë bashkëpunimi ndër institucional në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit vazhdon të mbetet një sfidë.

Rekomandimi i AKK-së për krijimin e një trupi koordinues të përbashkët të të gjitha institucioneve anti- korrupsion që veprojnë në Kosovë ku do të përfaqësoheshin në nivel të krerëve institucional nuk është adresuar akoma. Këshilli Kombëtar kundër Korrupsionit i iniciuar dhe i udhëhequr nga Presidentja e vendit nuk i ka dhënë rezultatet e pritura, si dhe nuk ka arritur që të adresoj rekomandimin e AKK-së për një trupë koordinuese anti-korrupsion.

Bashkëpunimi me Prokuroritë sa i përket informatave kthyesë tek Agjencia për procedimin e mëtutjeshëm dhe vendimin final lidhur me rastet e përcjella është avancuar dukshëm dhe ka qenë i qëndrueshëm. Në shumicën e rasteve AKK ka pranuar njoftime me shkrim nga Prokuroria. Brenda afateve të arsyeshme kohore AKK ka pranuar konfirmime nga ana e Prokurorive dhe Policisë së Kosovës nëse në rastet e njëjta të raportuara në AKK është iniciuar dhe zhvillohet procedura penale në mënyrë që rastet e njëjta të mos hetohen në të njëjtën kohë nga dy institucione dhe të mos zhvillohen dy procedura të ndara. AKK gjatë gjithë vitit, në baza mujore, ka shkëmbyer informacione

me Prokuroritë Themelore rreth numrit të rasteve të përcjella në shërbim të harmonizimit të statistikave.

Brenda kompetencave ligjore AKK ka shkëmbyer informacione dhe dokumentacione me të gjitha institucionet tjera që kanë për mision luftimin dhe parandalimin e korrupsionit. Në këtë kuptim AKK ka ofruar informacione për institucionet kompetente lidhur me verifikimin e të kaluarës së personave të caktuar.

Në kuadër të aktiviteteve për avancimin e bashkëpunimit dhe forcimin e mëtutjeshëm të tij AKK në shkurt ka qenë nikoqire e 30 kandidatëve për gjyqtarë dhe prokuror në Republikën e Kosovës në kuadër të programit trajnues të organizuar nga *Instituti Gjyqësor i Kosovës – IGJK*.

Në Podgoricë me 27 shkurt AKK ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me Komisionin për Parandalimin e Konflikti të Interesit nga Mali i Zi me qëllim të forcimit të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave në mes këtyre dy institucioneve për zbatimin e standardeve ndërkombëtare ligjore dhe rregulloreve të brendshme të tyre.

Përkrahur nga Programi Anti-Korrupsion i UNDP-së dhe SDC, zyrtarët e Agjencisë, Prokuroria e Shtetit, shtatë kryeprokurorët e Prokurorisë Themelore të Kosovës, zyrtarët e Policisë së Kosovës nga Drejtoria për Hetimin e krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, me 26.05.2014, u mbledhën në një punëtori dy ditore në Ohër për të diskutuar sfidat aktuale (çështje praktike) në mes këtyre mekanizmave dhe mënyrën se si mund të rrisin bashkëpunimin për të pasur rezultate në fushën e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit.

Si rezultat edhe i kësaj punëtorie në të gjitha Prokuroritë Themelore janë caktuar prokurorë kontaktues me AKK-në dhe tashmë zyrtarët e AKK-së në shumë raste janë kontaktuar nga prokurorët e lëndëve gjatë zhvillimit të hetimeve të mëtutjeshme.

Duke marrë parasysh faktin se prokurorët dhe gjyqtarët e rinj shpeshherë kanë kërkuar konsultime me zyrtarët e AKK-së lidhur me përmbajtjen e Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik Dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë si dhe të Ligjit nr. 04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotësimin e këtij ligji, me qëllim të procedimit të lëndëve si rezultat i dështimit për ti përmbushur obligimet të cilat burojnë nga aty për zyrtarët e lartë publik, AKK me 23 tetor ka organizuar takimin e përbashkët me ta.

Me rastin e Ditës ndërkombëtare kundër korrupsionit (09 dhjetor), AKK e mbështetur nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX ka nis fushatën sensibilizuese kundër korrupsionit, që synon të nxisë publikun kosovar të jetë pjesë e përpjekjeve të institucioneve shtetërore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Kosovë.

Kjo fushatë e përbashkët përqendrohet në atë se si korrupsioni e rrezikon sundimin e ligjit, stabilitetin social, barazinë dhe zhvillimin ekonomik. Për herë të parë zyrtarët e lartë shtetëror të Kosovës bashkërisht kanë nënshkruar një Kartë Përkushtimi me zotime publike që do të jenë të bashkuar në luftën kundër korrupsionit. Karta e nënshkruar e përkushtimit ka filluar të vendoset në institucionet publike kryesore, në vende ku qytetarët frekuentojnë më shumë dhe është botuar në gazetatat ditore.

Në kuadër të fushatës janë transmetuar spotet televizive me thirrje sensibilizuese anti-korrupsion të Presidentes së Republikës së Kosovës, U.D-së së Kryeprokurorit të Shtetit, Drejtorit të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtorit të Policisë së Kosovës, Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Drejtorit të Doganave, Drejtorit të Administratës Tatimore të Kosovës, Drejtorit të Shërbimit Spitalor

Klinik Universitar të Kosovës të cilët zotohen që ta luftojnë korrupsionin. Spotet televizive janë transmetuar në Radio Televizionin e Kosovës (RTK).


5.2 Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit 2013-2017

Strategjia kundër korrupsionit dhe Plani i Veprimit 2013-2017 janë dy dokumente të politikave anti korrupsion, të cilat janë miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës në shkurt të 2013, Plani i veprimit është projektuar për të zbatuar objektiva e përgjithëshme strategjike përmes masave specifike dhe konkrete kundër korrupsionit. Ai përbëhet nga objektivat specifike të plan-veprimit, masave apo veprimeve së bashku me treguesit e suksesit dhe janë përcaktuar afatet kohore.

AKK është përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të Strategjisë nëpërmjet masave të parashikuara në Planin e veprimit kundër korrupsionit.

AKK me 7 korrik 2014 ka kërkuar raporte nga pikat e kontaktit¹ të përfshira në Planin e veprimit që deri më 18 korrik 2014, të paraqesin raporte për periudhën janar - qershor 2014, mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit 2013-2017 si dhe AKK ka kërkuar raporte nga pikat e kontaktit me 12 janar 2015 që deri më 20 janar 2015, të paraqesin raporte për periudhën korrik - dhjetor 2014. Në procesin e raportimit kanë qenë të përfshirë institucionet qendrore dhe lokale publike, sektori privat dhe shoqëria civile.

Për periudhën raportuese, janar-dhjetor 2014, Plani i veprimit 2013-2017 ka dhënë një total prej 267 veprimeve apo masave. Pikat e kontaktit gjatë kësaj periudhe raportuese nuk kanë raportuar fare për 89 veprime/masa apo 33.33%. Për 178 veprime të tjera të raportuara nga pikat e kontaktit dhe në bazë të raporteve të marra, AKK ka nxjerr një përfundim se 125 veprime janë realizuar apo janë në realizim e sipër apo 46.81%, 23 veprime janë pjesërisht të realizuara apo 8.61% dhe 30 veprime janë të pa realizuara apo 11.23% siç janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



Grafiku 4. Monitorimi i zbatimit të Strategjisë

¹ Pika e Kontaktit - është person përgjegjës i cili raporton në AKK për Institucionin nga i cili vjen.

Pikat e Kontaktit që nuk kanë raportuar fare për periudhën Janar – Qershor 2014 janë: Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Tokologjisë, Asociacioni i Gazetarëve Profesionist të Kosovës, Oda Ekonomike e Kosovës, Shoqëria Civile duke përfshirë (Organizatën “FOL” dhe “KDI”).

Ndërsa, Pikat e Kontaktit që nuk kanë raportuar fare për periudhën korrik - dhjetor 2014 janë: Asociacioni i Gazetarëve Profesionist të Kosovës, Oda Ekonomike e Kosovës, Shoqëria Civile duke përfshirë (Organizatën “FOL” dhe “KDI”).²

6. PARANDALIMI I KORRUPSIONIT

Gjithë aktiviteti për parandalimin e korrupsionit në kuadër të AKK, zhvillohet nga Departamenti për Parandalimin e Korrupsionit. Kjo bëhet sipas mandatin të dhënë me Ligjin nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Ligjin nr.04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, Ligjit nr. 04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë si dhe Ligjin nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Departamenti për Parandalimin e Korrupsionit aktivitetin e tij e zhvillon përmes tri divizioneve; Divizioni për Mbikëqyrjen e Pasurisë dhe Dhuratave, Divizioni për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik.

6.1 Mbikëqyrja dhe kontrolli i pasurisë dhe i dhuratave

Baza ligjore në të cilën AKK e mbështet punën e vet për mbikëqyrjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë është e definuar në Ligji Nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë, si dhe Ligjin Nr. 04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë.

AKK mbikëqyrë pasurinë e zyrtarit të lartë publik në bazë të informacionit të dorëzuar nga zyrtarët e lartë publik në formular të posaçëm, i cili është përgatitur nga AKK në pajtim me ligjin në fuqi. Formularët duhet të plotësohen nga zyrtarët e lartë publik dhe të dorëzohen në AKK.

6.1.1 Llojet e deklarimit të pasurisë

Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë, përcakton këto lloje të deklarimeve:

- Deklarimi i rregullt vjetor;
- Deklarimi me marrjen e detyrës;
- Deklarimi sipas kërkesës së Agjencisë;
- Deklarimi pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni.

² Në web faqen e AKK-së janë detajisht të publikuara të dhënat mbi monitorimin vjetor për zbatueshmërinë e Planit të Veprimit kundër Korrupsionit 2013-2017. <http://www.akk-ks.org/repository/docs/Raporti.pdf>

Deklarimi i rregullt vjetor - Zyrtarët e lartë publik kanë për obligim deklarin e rregullt vjetor të pasurisë gjatë tërë kohës së punës në shërbimin publik dhe në afate të përcaktuara me ligj. Zyrtarët e lartë publik detyrohen të deklarojnë gjendjen e pasurive të tyre në AKK, nga 1 deri më 31 mars të çdo viti. Për këtë periudhë kohore ose deklarin e rregullt vjetor për vitin 2014 kanë pasur për obligim që ta bëjnë deklarin e pasurisë së tyre 3038 zyrtar të lartë publik. Prej këtij numri të përgjithshëm e kanë deklaruar pasurinë 3030, ose 99.74%, deklarin nuk e kanë bërë 2 zyrtar, ndërsa 6 zyrtar të lartë publik nuk kanë pasur mundësi të deklarojnë për arsye të njohura.

Për periudhën raportuese gjendja e përgjithshme e procesit të deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Institucionet	Numri i zyrtarëve	Të deklaruar		Nuk kanë deklaruar		
		Deklarimet	Përqindjet	Mos deklarimet	Mos deklarimi me arsye	Përqindjet
Presidenca	17	17	100%	/	/	0.00 %
Kuvendi	138	137	99.27 %	/	1	0.73 %
Qeveria	1143	1142	99.91 %	/	1	0.09 %
Gjykatat	351	351	100 %	/	/	0.00 %
Prokurorit	129	128	99.22 %	/	1	0.78 %
Institucionet e Pavarura	356	355	99.71 %	1	/	0.29 %
Komunat e Kosovës	608	604	99.34 %	1	3	0.66 %
Ndërmarrjet Publike	296	296	100 %	/	/	0.00 %
TOTALI	3038	3030	99.74 %	2	6	0.26 %

Tabela 4. Deklarimi i rregullt vjetor

Deklarimi me marrjen e detyrës së zyrtarëve të lartë publik - Zyrtarët e lartë publik të cilët fillojnë punën në shërbimin publik në mënyrë të plotë dhe reale deklarojnë me shkrim pasurinë e tyre brenda afatit ligjor. Organi i punësimit është i detyruar që brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditor ta njoftoj AKK për fillimin apo përfundimin e punës së zyrtarit të lartë publik, ndërsa zyrtari i lartë publik ka për obligim deklarin e pasurisë brenda periudhës 30 ditësh nga dita e marrjes së detyrës.

Gjatë vitit raportues kanë pasur për obligim deklarin e pasurisë me marrjen e detyrës 1052 zyrtar të lartë publik, nga numri i përgjithshëm 1012 kanë bërë deklarin e pasurisë ose 96%, ndërsa nuk e kanë deklaruar pasurinë 41 ose 4%. Gjendja e përgjithshme e procesit të deklarimit të pasurisë me marrjen e detyrës për vitin 2014 paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Institucionet	Numri i zyrtarëve	Të deklaruar		Nuk kanë deklaruar	
		Deklarimet	Përqindjet	Mos deklarimet	Përqindjet
Presidenca	0	0	0%	0	0%
Kuvendi	78	78	100%	0	0%
Qeveria	121	121	100%	0	0%
Gjykatat	3	3	100%	0	0%
Prokurorit	22	22	100%	0	0%
Institucionet e Pavarura	07	7	100%	0	0%
Komunat e Kosovës	802	761	95.01%	41	4.99%
Ndërmarrjet Publike	19	19	100%	0	0%
TOTALI	1052	1011	96%	41	4%

Tabela 5. Deklarimi me marrjen e detyrës.

Deklarimi sipas kërkesës së Agjencisë - AKK në çdo kohë mund të kërkojë nga zyrtari i lartë publik deklarin e pasurive dhe burimet e krijimit të tyre në pajtim me ligjin. Gjatë kësaj periudhe raportuese AKK ka kërkuar nga 88 zyrtar të lartë publikë deklarin e pasurisë sipas kërkesës.

Gjendja e deklarimit të pasurisë sipas kërkesës paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Institucionet	Të deklaruar		
	Numri i zyrtarëve	Deklarimet	Përqindjet
Presidenca	0	0	0%
Kuvendi	0	0	0%
Qeveria	16	16	100%
Gjykatat	4	4	100%
Prokurorit	0	0	0%
Institucionet e Pavarura	0	0	0%
Komunat e Kosovës	59	59	100%
Ndërmarrjet Publike	9	9	100%
TOTALI	88	88	100%

Tabela 6. Deklarimi sipas kërkesës së AKK-së.

Deklarimi i pasurisë pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni - Pas përfundimit të punës në pozitën e lartë publike, zyrtarët e lartë publik kanë për obligim deklarimin e pasurisë brenda afatit tredhjet (30) ditor. Gjatë kësaj periudhe deklarimin e pasurisë pas largimit nga funksioni publik kanë pasur për obligim të deklarojnë 1018 zyrtar të lartë publik, nga numri i përgjithshëm 968 kanë bërë deklarimin e pasurisë ose 95%, ndërsa nuk e kanë deklaruar pasurinë 50 ose 5%. Gjendja e përgjithshme e procesit të deklarimit të pasurisë pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni publik paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Institucionet	Numri i zyrtarëve	Të deklaruar		Nuk kanë deklaruar	
		Deklarimet	Përqindja	Mos deklarimet	Përqindja
Presidenca	0	0	100%	0	0%
Kuvendi	78	78	100%	0	0%
Qeveria	97	97	100%	0	0%
Gjykatat	5	5	100%	0	0%
Prokurorit	0	0	100%	0	0%
Institucionet e Pavarura	2	2	100%	0	0%
Komunat e Kosovës	817	767	93%	50	6.1%
Ndërmarrjet Publike	19	19	100%	0	0%
TOTALI	1018	968	94%	50	6%

Tabela 7. Deklarimi i pasurisë pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni publik.

Nga fillimi i vitit raportues kemi pasur angazhim të vazhdueshëm duke filluar me procesin e deklarimit të pasurisë për nivelin komunal që ka rezultuar me një numër jashtëzakonisht të madh të zyrtarëve që janë emëruar apo zgjedhur dhe po ashtu edhe kanë përfunduar mandatin. Këtë vit kemi filluar me procesin e deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të zgjedhur edhe të emëruar edhe në katër komunat e pjesës veriore të Kosovës. Në vitin raportues kanë përfunduar mandatin edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe janë zgjedhur deputetët e rinj dhe kabineti qeveritar. Të gjithë deklarimet e pranuar gjatë vitit janë regjistruar në data bazë dhe janë publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë. Pasqyrimi i deklarimit vjetor për të gjitha llojet e deklarimit të pasurisë :

Lloji i deklarimit	Të obliguar	Kanë deklaruar	Nuk kanë deklaruar
Deklarimi i rregullt vjetor	3038	3036	02
Me marrjen e detyrës	1052	1011	41
Sipas kërkesës	88	88	0
Pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni	1018	968	50
Numri i përgjithshëm	5196	5103	93

Tabela 8. Pasqyrimi i deklarimit vjetor për të gjitha llojet

6.1.2 Kontrolli i deklarimit të pasurisë

Bazuar në mandatin që ka, AKK ka zhvilluar kontrollin paraprak dhe kontrollin e plotë të formularëve për deklarim të pasurisë të paraqitur nga zyrtarët e lartë publik.

Kontrolli paraprak - Kontrolli paraprak kryhet për çdo formular për të verifikuar ekzistimin/ apo mos ekzistimin e gabimeve materiale ose plotësimeve të gabuara të formularit. Gjatë regjistrimit të të dhënave në data bazë kemi bërë edhe kontrollin paraprak, ku kemi vërejtur shumë gabime në plotësimin e formularëve për deklarim të pasurisë, gabime më të theksuara i kemi vërejtur tek zyrtarët e lartë publik që kanë deklaruar pasurinë për herë të parë. Në rastet kur kemi vërejtur gabime të vogla apo gabime të cilat kemi pasur mundësi për mirësimi përmes kontaktit telefonik, ne i kemi kontaktuar dhe i kemi evituar ato gabime teknike. Në rastet më të theksuara ju kemi drejtuar me shkresë zyrtare. Në 967 raste kemi vërejtur gabime teknike tek formularët për deklarim të pasurisë së paraqitur, 879 zyrtarë të lartë publik i kemi kontaktuar përmes telefonit dhe i kemi evituar gabimet teknike, ndërsa 88 zyrtarë të lartë publik ju kemi drejtuar me shkresë zyrtare për evitimin e gabimeve teknike.

Kontrolli i plotë - Kontrolli i plotë kryhet për ta verifikuar vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të deklaruara në formular. AKK ka obligim ligjor për të zhvilluar kontrollin e plotë për zyrtarët e lartë publikë të cilët deklarojnë pasurinë. Gjatë periudhës raportuese AKK ka bërë kontrollin e plotë për 20% nga numri i përgjithshëm i deklarimeve në bazë të shortit të organizuar për herë parë i cili parashihet me ligjin për deklarim të pasurisë. Po ashtu kemi trajtuar të gjitha informacionet që kemi pasur sa i përket deklarimit të pasurisë.

AKK ka bërë krahasimin e të dhënave të deklaruara ndër vite, krahasimin e të dhënave të pranuar nga institucionet tjera si: Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Ministria e Administratës Publike, Ndërmarrjet Publike, Agjencia e Regjistrimit të Veturave, Administrata Tatimore e Kosovës etj. Nga numri i përgjithshëm i zyrtarëve të lartë publik që kanë për obligim deklarimin e pasurisë janë kontrolluar 584 formular, ku në 187 raste janë vërejtur ndryshime dhe kemi kërkuar sqarime shtesë, ndërsa 77 janë përcjellë për trajtim si raste të dyshuara të Konfliktit të Interesit, si dhe 11 raste i kemi dërguar për paraqitjen e kallëzimeve penale.

Agjencia i ka trajtuar ex- officio edhe 14 raste të raportuara nga qytetarët përmes formave të ndryshme. Tabela e mëposhtëm pasqyron procesin e përgjithshëm të deklarimit të pasurisë, si dhe rezultatet e gjetjeve nga kontrolli i plotë.

Obligim për deklarim	Kanë deklaruar	Nuk kanë deklaruar	Kontrolli i Plotë	Ndryshime të evidentuara gjatë kontrollit të plotë dhe kërkesa sqarime	Dërguar për trajtim të Konfliktit të interesit	Të përcjellura në DLK	Nuk ka pasur ndryshime
5196	5103	93	598	187	77	20	314

Tabela 9. Procesi i përgjithshëm i deklarimit të pasurisë si dhe rezultatet e gjetjeve nga kontrolli i plotë.

6.1.3 Katalogu i dhuratave

Bazuar në Ligjin nr. 04/L-050 si dhe Ligjin Nr. 04/L-228, Institucionet publike duhet t'i emërojnë zyrtarët përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të dhuratave. Të gjitha dhuratat e pranuar dhe vlera e tyre përkatëse, si dhe emrat e personave që kanë dhënë dhuratën, duhet të regjistrohen në regjistrin e dhuratave nga personi zyrtar që përcaktohet nga Agjencia dhe që mbahen nga institucioni, në të cilin personi zyrtar ushtron detyrën. Kopjet e katalogëve duhet t'i dërgojnë në AKK jo më vonë se më 31 mars të vitit në vijim.

- Dorëzimi i katalogut të Dhuratave**

AKK, gjatë muajit mars të vitit 2014 ka pranuar njoftimin nga dymbëdhjetë (12) institucione të cilat kanë deklaruar se kanë pranuar dhurata, ndërsa tridhjetë e dy (32) institucione tjera kanë deklaruar se nuk kanë pranuar dhurata gjatë vitit paraprak. Ndërsa nga institucionet tjera nuk kemi pranuar njoftime lidhur me pranimin ose jo të dhuratave.

Institucionet të cilat kanë dorëzuar kopjet e katalogut të dhuratave gjatë këtij viti për vitin paraprak janë: Presidenca 85 dhurata të protokollare; Kuvendi i Kosovës 7 dhurata protokollare; Zyra e Kryeministrit 7 dhurata protokollare dhe 11 të rastit; Ministria e Punëve të Jashtme 6 dhurata protokollare dhe 1 e rastit; Dogana e Kosovës 6 dhurata të rastit; Ministria e Integritetit Evropian 1 dhuratë protokollare dhe 1 të rastit; Gjykata Kushtetuese 2 dhurata protokollare; Prokuroria e Shtetit 7 dhurata protokollare dhe 2 të rastit; Instituti Gjyqësor i Kosovës 5 dhurata protokollare; Institucioni i Avokatit të Popullit 2 dhurata protokollare; Komuna e Prishtinës 1 dhuratë të rastit; Komuna e Podujevës 1 dhuratë të rastit.

Të dhënat e specifikuar lidhur me katalogët e dhuratave sipas institucioneve që i kanë dorëzuar kopjet e katalogut në AKK, janë të paraqitura në tabelën në vijim.

Institucioni	Protokollare	Rastit	Numri i dhuratave të deklaruar
Presidenca	85	00	85
Kuvendi i Kosovës	07	00	07
Zyra e Kryeministrit	07	11	18
Ministria e Punëve të Jashtme	06	01	07
Dogana e Kosovës	00	06	06
Ministria e Integritetit Evropian	01	01	02
Gjykata Kushtetuese	02	00	02
Prokuroria e Shtetit	07	02	09
Instituti Gjyqësor i Kosovës	05	00	05
Institucioni i Avokatit të Popullit	02	00	02
Komuna e Prishtinës	00	01	01
Komuna e Podujevës	00	01	01
Totali	122	23	145

Tabela 10. Pasqyra e pranimit të dhuratave nëpër institucione.

- Kontrolli i Dhuratave**

Në bazë të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, dhe Ligjin nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë, si dhe Ligji Nr. 04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë

Personat Zyrtarë, Agjencia ka vazhduar të bëjë kontrollin nëpër institucione lidhur me mbajtjen dhe evidentimin e dhuratave të pranuar.

Gjatë periudhës raportuese kemi vizituar 25 (njëzetepesë) institucione. Qëllimi i vizitës së zyrtarëve të Agjencisë ka qenë që të shohim nga afër se si po zbatohen dispozitat e legjislacionit të lartë përmendur lidhur me regjistrimin dhe mbajtjen e katalogëve të dhuratave.

Të dhënat e specifikuar lidhur me katalogët dhe regjistrin e dhuratave sipas institucioneve që mbajnë dhe kanë dorëzuar kopjet e katalogut në AKK, janë të paraqitura në mënyrë tabelare.

Tabela nga vizita në lidhje me kontrollin e dhuratave

Nr.	Institucionet	E mbajnë katalogun	Llojet e dhuratave		
			Protokollare	Të rastit	Gjithsej
1	Agjencia për Menaxhimin e Pasurive të Sekuestruara	-	-	-	-
2	Shërbimi Korrektues	-	-	-	-
3	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës	-	-	-	-
4	Agjencia e Labororit dhe Forenzikës	-	-	-	-
5	Dogana e Kosovës	+	0	1	1
6	Inspektorati Policor i Kosovës	-	-	-	-
7	Agjencia e Menaxhimit Emergjent	-	-	-	-
8	Administrata Tatimore e Kosovës	-	-	-	-
9	Këshilli i Sigurisë i Kosovës	-	-	-	-
10	Agjencia për Barazi Gjinore	-	-	-	-
11	Instituti i Kosovës për Administratë Publike	-	-	-	-
12	Agjencia Pyjore e Kosovës	+	-	-	-
13	Agjencia e Statistikave të Kosovës	-	-	-	-
14	Agjencia Shtetërore e Arkivave	-	-	-	-
15	Agjencia Kadastrale e Kosovës	-	-	-	-
16	Agjencia e Regjistrimit Civil	-	-	-	-
17	Policia e Kosovës	-	-	-	-
18	Akademia e Kosovës për Siguri Publike	-	-	-	-
19	Komuna e Prishtinës	+	-	1	1
20	Komuna e Gjakovës	-	-	-	-
21	Komuna e Gjiçanit	-	-	-	-
22	Komuna e Pejës	+	1	3	4
23	Komuna e Prizrenit	-	-	-	-
24	Komuna e Mitrovicës	-	-	-	-
25	Komuna e Ferizajt	-	-	-	-
Gjithsejtë			1	5	6

Tabela 11. Pasqyra e kontrollit të dhuratave sipas institucioneve

Si e metë kryesore konsiderohet të jetë mos mbajtja e regjistrit të dhuratave nga pjesa dërmuese e këtyre institucioneve dhe mos koordinimi sa i përket dhuratave të deklaruar nga zyrtarët e këtyre institucioneve dhe zyrtarëve të personelit.

Agjencia konsideron se nevojitet një përgjegjësi më e madhe nga zyrtarët të cilët pranojnë dhurata për ta plotësuar katalogun e dhuratave dhe për ta deklaruar atë te zyrtarët kontaktues të AKK-së, për institucionin të cilit ata i përkasin. Po ashtu është shumë e nevojshme që zyrtarët e personelit apo pikat kontaktuese që të mbajnë regjister të dhuratave pavarësisht se ka apo nuk ka dhurata të deklaruar nga zyrtarët e institucioneve ngase është obligim ligjor mbajtja e regjistrit.

6.2 Parandalimi i konfliktit të interesit

Agjencia Kundër Korrupsionit dhe konkretisht Divizioni për Parandalimin e Konfliktit të Interesit që nga themelimi i saj si institucion kompetent dhe i mandatuar, ka qenë e angazhuar në trajtimin, parandalimin, njoftimin dhe vetëdijshmin e zyrtareve të lartë, opinionit lidhur me parandalimin e konfliktit të Interesit, bazuar në Legjislacionin në fuqi.

Bashkëpunimi me Institucione- Gjate vitit 2014 Agjencia Kundër Korrupsionit, ka rritur bashkëpunimin në mes të institucioneve që duke shkëmbyer informata të cilat kanë ndikuar në rritjen e performancës në identifikimin trajtimin dhe parandalimin e konfliktit të Interesit.

AKK gjate kësaj periudhe ka shtrirë bashkëpunimin me institucionet siç janë: Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve(ARBK), Administratën Tatimore(ATK), Agjencinë e Regjistrimit Civil (ARC) të gjitha këto institucione që kanë ofruar informata shtesë gjate procesit të trajtimit të rasteve që lidhen me Konfliktin e Interesit.

Problemet Evidentuara- Duke vlerësuar aktivitetin dhe punën e bërë gjate vitit 2014 kemi identifikuar edhe disa probleme që lidhen me parandalimin e Konfliktit të interesit, duhet theksuar se problemet e evidentuar kanë qenë të natyrës teknike, vlen të ceket problemi të cilin e kanë pasur zyrtaret e lartë në largimin nga personat e autorizuar në bizneset e tyre apo ku kanë qenë duke punuar me herët për shkak të problemeve me bashkëpronar apo me pronaret që nuk kanë kontakte apo nuk gjenden e shtetin tone, po ashtu problemet materiale, që janë vërejtur nga AKK, lidhur me parandalimin e konfliktit të interesit kanë të bëjnë me legjislacionin në fuqi i cili nuk i ka parapa disa situata që në si autoritet mendojmë që duhet të ishin të rregulluar me akte ligjor, që do të kishte një efekt edhe mëte mëte në parandalimin e Konfliktit të interesit.

Kërkesat e Institucioneve Dhe Zyrtareve të Lartë për vlerësimin e situatave të Konfliktit të Interesit -Gjate vitit 2014 është vërejtur një rritje e kërkesave të institucioneve dhe zyrtareve të lartë që kanë bërë në AKK-ë për vlerësimin dhe trajtimin e situatave që lidhen me Konfliktit të Interesit në ushtrim të funksionit publik, kjo është bërë duke marrë parasysh edhe efektin që ka pasur hyrja në fuqi e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ku në disa raste Konflikti i Interesit cilësohet edhe si vepër penale.

Trajnimet dhe Takimet informuese me Zyrtar dhe Institucione - gjatë vitit që po raportojmë zyrtaret e AKK-se kanë zhvilluar një numër Trajnimesh dhe Takimesh informuese me zyrtaret e lartë të nivelit qendrorë dhe lokal, si dhe me përfaqësues të institucioneve të ndryshë që kanë për obligim zbatimin e ligjeve që lidhen me fushën e konfliktit të Interesit.

Divizionit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit gjate vitit 2014 ka rritur performancën sa i përket identifikimit dhe trajtimit të rasteve që lidhen me situata të Konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit Publik, për arsye se është rritur numri i rasteve të trajtuara në këtë vit.

Burimet e identifikimit të rasteve të konfliktit të interesit - Duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, AKK shfrytëzon shumë burime me anë të cilave mund të identifikoj rastet me elemente të konfliktit të mundshëm të interesit.

Si burime kryesore dhe bazike të identifikimit të rasteve të konfliktit të interesit janë: formularët e deklarimit të gjendjes së pasurisë, mediat (elektronike apo të shkruara), ankesat e deponuara nga qytetaret, regjistrat e ndryshëm zyrtar, po ashtu ekzistojnë edhe burime tjera zyrtare që i shfrytëzon AKK, siç janë: Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve Administrata Tatimore e Kosovës, Agjencia e Regjistrimit Civil etj.

Rastet e konfliktit të interesit gjatë vitit 2014 - Në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, dhe në përgjithësi të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit, Divizioni për parandalimin e konfliktit të interesit ka zhvilluar një numër të aktiviteteve të caktuara që për qëllim ka pasur paralajmërimin e zyrtareve të lartë për parandalimin dhe për shmangien nga konflikti i interesit, si dhe ka ofruar për institucione qendrore dhe lokale opinione për situata të konfliktit të interesit.

Gjatë periudhës raportuese AKK ka trajtuar **264** raste të dyshuara për konflikt të interesit. I gjithë procesi ka kaluar përmes një bashkëpunimi që AKK ka me Institucionet Publike, Autoritetet Përgjegjëse, me Nëpunësit Publikë, me media, shoqërinë civile, si dhe përmes informacioneve të marra nga burime të ligjshme.

Tabela në vijim pasqyron procesin dhe rastet e trajtuara në total për konflikt të interesit gjatë vitit 2014.

Institucioni	Rastet të paraqitura për Konflikt të interesit	Raste që janë shmangur nga Konflikti i Interesit	Raste Pa Konflikt Interesi	Opinione	Rastet e përcjella për hetim	Kërkesa për shkarkim/kundërvajtje	Raste ende në procedim
Qeveria	67	31	4	19	/	2	11
Kuvendi i Kosovës	5	1	1	3	/	/	/
Gjykata /Prokuroria	13	5	1	1	/	/	6
Agjenci te pavarura	20	8	1	6	/	/	5
Ndërmarrje Publike	33	16	4	9	/	/	4
Pushteti Lokal	126	77	23	8	3	5	10
Totali	264	138	34	46	3	7	36

Tabela 12. Rastet e trajtuara në total për konflikt të interesit gjatë vitit 2014.

Nga 53 raste që kanë qenë në procedurë të bartura nga viti 2013 në vitin 2014, në 44 raste është shmangur konflikti i interesit, 6 raste kanë rezultuar pa konflikt interesi, dhe janë nxjerr 3 opinione.

Agjencia në pesë (5) raste ka kërkuar nga institucionet ku zyrtarët e lartë ushtrojnë funksionin që të fillojnë procedurën e shkarkimit kundër Flamur Keqa- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Sretko Spasic- Komuna e Klllokotit, Refki Gega- Komuna e Therandës, Viktor Mehana- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Bojan Stamenkovic- Komuna e Ranillugut. Nga këta vetëm për rastin e Flamur Keqa kemi pranuar informacion kthyes, përderisa për rastet tjera nuk është pranuar informacioni kthyes.

Në dy (2) raste është iniciuar procedura kundërvajtëse pa kërkesë për shkarkim kundër Tasim Gubetini- Komuna e Vushtrrisë dhe Ndue Shabani – Komuna e Klinës.

Funksionet e shumëfishta

Na numri i përgjithshëm i formularëve të pranuar gjatë periudhës raportuese janë identifikuar zyrtarë të lartë të cilët ushtrojnë apo mbajnë dy e më shumë funksione/pozita. Kjo dukuri në aspektin ligjor nuk përbën vepër penale, por mund të paraqet rrezik potencial të burimit të konfliktit të interesit.

Në numra kjo gjetje pasqyrohet si në vijim: gjithsejtë janë identifikuar 1509 zyrtarë të lartë të cilët ushtrojnë apo mbajnë dy e më shumë funksione/pozita. Në 1 rast një zyrtarë i lartë mban 6

funksione/pozita, 10 zyrtarë mbajnë nga 5 funksione/pozita, 31 zyrtarë nga 4 funksione/ pozita, 312 zyrtarë me nga 3 funksione/pozita dhe 1155 zyrtarë me nga 2 funksione/pozita.

Në mënyrë tabelare, këto të dhëna duken si në tabelën.

6 funksione/ pozita	5 funksione/ pozita	4 funksione/ pozita	3 funksione/ pozita	2 funksione/ pozita	Gjithsejtë
1	10	31	312	1155	1509

Tabela 13. Funksionet e shumëfishta

6.3 Parandalimi i Korrupsionit në aktivitetet e Prokurimit Publik

Aktivitetet e parandalimit të korrupsionit në fushën e prokurimit publik nga ana e Agjencisë i zhvillon Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik.

Për realizimin e këtyre aktiviteteve Agjencia mbështetet fillimisht në Ligjin mbi Agjencinë, Ligjin mbi Konfliktin e Interesit si dhe mbi monitorimin e zbatueshmerisë së këtij kuadri ligjor: Ligjin mbi Prokurimin Publik, Ligjin për Partneritetet Publiko-privat, Ligjin për Standardizimin, Ligjin për shoqëritë tregtare, Ligjin për Administratën Tatimore, Ligjin për markat si dhe ligjet tjera që janë relevante për Parandalimin e Korrupsionit.

Me qëllim të parandalimit të korrupsionit AKK ka trajtuar shumë burime te informacionit dhe ka intervenuar në rastet kur ka pasur dyshim se ka mosrespektim të ligjit në fushën e Prokurimit Publik.

Mirëpo përkrah këtyre ligjeve, AKK përkujdeset edhe për implementimin e dokumenteve të legjislacionit dytësor nga subjektet tenderuese, veçanërisht të këtyre akteve: Rregullave për procedurat e prokurimit; Kodit Etik të Prokurimit; Rregullores mbi Procedurën e Shqyrtimit; Udhëzuesit për Procedurat e Prokurimit Publik.

Divizioni për parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik gjatë vitit 2014 në vazhdimësi ka siguruar përcjelljen e publikimeve të autoriteteve kontraktuese për aktivitet e tyre në web faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) dhe publikimet në media të cilat i ka konsideruar si burime informacioni për shkeljet e mundshme ligjore në prokurimin publik. Me theks të veçantë për këtë divizion janë informacionet e pranuar nga qytetarët, operatorët ekonomik te ndryshëm në lidhje me dyshimet për veprimet korruptive në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit.

Në vitin 2014 kemi identifikuar 86 raste të ndryshme për shkelje të mundshme të LPP, për të cilat është marre Vendim për fillimin e procedurës së parandalimit të korrupsionit në prokurimin publik. Ndërsa për trajtimin e rasteve në kemi paraqitur 97 kërkesa të autoritetet kontraktues të nivelit lokal dhe qendror, me të cilat kemi kërkuar dokumentacion për aktivitetet e caktuara të prokurimit, ku i tërë dokumentacioni na është ofruar brenda afatit të kërkuar.

Në përmbushje të obligimit ligjor me qëllim të monitorimit të aktivisteve të prokurimit kemi paraqitur 15 njoftime për pjesëmarrje në vëzhgim, me të cilat kemi informuar autoritet kontraktuese se do jemi pjesë e vëzhgimit në ekzaminim, vlerësim dhe krahasim të ofertave për aktivitetet e caktuara të prokurimit. Vlen të theksohet se të gjitha autoritet e kanë informuar Agjencinë për kohën dhe vendin e saktë të fillimit të procesit të vlerësimit. Andaj zyrtarët e divizionit për parandalim kanë marrë pjesë në cilësinë e vëzhguesit gjatë zhvillimit të procedurave të disa tenderëve, dhe në raste të caktuara kemi vërejtur favorizime të operatorëve ekonomik, apo mosrespektim të dispozitave ligjore, dhe si divizion kemi dhënë rekomandime për autoritetet kontraktuese, ku të njëjtit pastaj

kanë vepruar në pajtueshmëri me rekomandimet tona të bazuara në ligj. Vlen të theksohet se ky vit karakterizohet me rritje të bashkëpunimit mes institucioneve të Republikës së Kosovës dhe Agjencisë kundër Korrupsionit, me funksion të rritjes së transparencës kemi pranuar ftesë zyrtare për vëzhgimin e procesit të prokurimit nga këto institucione: Prokuroria e Shtetit, Ministria e Shëndetësisë, Universiteti i Prishtinës, Dogana e Kosovës AQP, RTK, KEKU, Komuna e Prishtinës.

Në DPKPP gjatë vitit raportues janë trajtuar gjithsej **86** lëndë në fushën e parandalimit të korrupsionit në prokurimin publik. Gjatë trajtimit të tyre, për **67** raste janë ofruar opinione parandaluese; **57** opinione me shkelje; për **7** raste është ofruar opinion pa shkelje; **3** raste opinioni nuk është përfillur; **6** raste janë mbyllur pa asnjë propozim; **7** raste AKK ka marr pjesë si vëzhgues; **2** raste janë përcjellë në Departamentin për Luftimin e Korrupsionit; **4** raste janë në procedurë trajtimi.

Tabela e mëposhtme pasqyron saktë rastet të cilat Agjencia i ka trajtuar gjatë vitit 2014 në fushën e parandalimit të korrupsionit në Prokurimin Publik

Lëndë të trajtuara	Opinione	Pa propozim	Vëzhgues	Të përcjella për hetime në DLK	Në procedurë
86	67	6	7	2	4

Tabela 14. Pasqyra e rezultateve të lëndëve të trajtuara

6.3.1 Opinione parandaluese

Opinione parandaluese me shkelje - Për 67 raste kemi ofruar opinione parandaluese për aktivitet e prokurimit të shpallura në web të KRPP-se. Agjencia ka trajtuar këto raste dhe ka konstatuar shkelje të dispozitave përkatëse të Ligjit për Prokurim Publik dhe iu ka rekomanduar Autoriteteve Kontraktuese anulimin e aktiviteteve të prokurimit. Vlen të ceket se në 10 aktivitete ku kemi marr pjesë në cilësinë e vëzhguesit Agjencia ka ofruar 10 opinione parandaluese të cilat autoritet kontraktuese i kanë respektuar duke bërë anulimin e aktiviteteve të prokurimit.

Opinione pa shkelje - Për 7 raste kemi ofruar opinione pa shkelje të LPP, për të cilat aktivitete të prokurimit Agjencia konsideron se procesi ka qenë i rregullt dhe në pajtim me ligjet në fuqi. (Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja).

Raste të mbyllura -Ndërsa për 6 raste DPKPP ka prezantuar raport për mbyllje pas pranimit të informacioneve nga autoritet kontraktuese se një aktivitet i tillë i prokurimit ka rezultuar me anulim nga OSHP-ja, apo në ditën që ne i kemi bërë kërkesë për dokumentacion si dhe në ato raste kur kemi ofruar këshilla nëpërmjet telefonit.

Pjesëmarrja si vëzhgues -Për 7 raste në të cilat kemi marrë pjesë në komisionet vlerësuese në cilësinë e vëzhguesit kanë përfunduar me raport për mbylljen me arsyetimin, se nuk ka pasur operator të përgjegjshëm, nuk ka interes autoriteti për një prokurim të mëtutjeshëm.

Opinionet pas njoftimit për dhënie të kontratës - Në opinionin e adresuar MSH për tenderin “Furnizim me material shpenzues medicinal nga lista esenciale” kemi hasur në veprime të cilat bien ndesh me dispozitat përkatëse të LPP. Në këtë rekomandim kemi kërkuar të shpërbëhet kontrata me operatorin fitues për të cilin dyshohet se kishte falsifikuar dokumentet ofertuese dhe kishte vënë në lajthitje OSHP-në dhe Autoritetin Kontraktues.

Ndërsa për rastin e trajtuar në KOSTT për tenderin me titull “ Instalimi i grupeve matëse në kufirin në mes të KOSTT/KEK/OSSH” kemi ofruar opinion me të cilin konsiderojmë se veprimet e autoritetit

kontraktues janë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LPP, duke e dëmtuar buxhetin në vlerë prej 400,000.00 € për të cilin dëm organet kompetente janë duke zhvilluar hetime. Sa i përket aktivitetit të prokurimit "Servisimi i pajisje radiologjike" në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, Agjencia për vite me radhë e ka përcjell këtë aktivitet të prokurimit dhe ka konsideruar se është një proces kompleks ku kemi rekomanduar autoritetin në fjalë të i jep zgjidhje të drejtë kësaj çështje pasi që bëhet fjalë për interesin e gjerë të qytetareve të Kosovës.

Përcjellja e rasteve në hetim -Për 2 raste kemi konsideruar se ka shkelje të dispozitave të Ligjit në fuqi për Prokurim Publik dhe në mungesë të kompetencës i kemi përcjell për hetim paraprak në Departamentin e Luftimit të Korrupsionit në kuadër të AKK-së.

Opinion me shkelje (lidhur me menaxhimin e kontratës) - Në një rast gjatë vitit 2014 kemi monitoruar menaxhimin e një kontrate publike në nivelin lokal, andaj duke u bazuar në raportin përfundimtar të pranimit kemi konsideruar se e tërë procedura e pranimit është zhvilluar sipas LPP.

Në vijim po paraqesim rastet në të cilat është ndërprerë aktiviteti i prokurimit pas Rekomandimeve të AKK-së ku kemi 67 opinionet e ofruara nga AKK drejt Autoriteteve Kontraktuese (Institucionet Publike), 64 raste janë respektuar rekomandimet e AKK për ndërprerjen e aktiviteteve të prokurimit.

Tabela në vijim pasqyron rastet në të cilat është ndërprerë aktiviteti i prokurimit pas Rekomandimeve të AKK-së, vlera e të cilëve **28,680,803.83**.

Nr	Institucioni	Emri i tenderit	Vlera e tenderit
1	Universiteti i Prishtinës	Akomodimi i studenteve dhe profesorëve gjatë mbajtjes së kursit nga lënda e skijimit	60,000.00
2	KOSTT	Shërbimet e sigurimit fizik të objekteve të KOSTT	163,000.00
3	Komuna e Prishtinës	Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve shëndetësore të kujdesit primar	250,000.00
4	QIRSK-Shtime	Ofrimi i shërbimeve për mirëmbajtje higjienike sanitare të ambientit dhe hapësirave të brendshme	50,840.00
5	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	Shërbimet e servisimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve TI-ve për SKGJK dhe Gjykatat e të gjitha regjioneve të Kosovës së bashku me degët.	93,427.00
6	KOSTT	Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes të KOSTT/KEK/OSSH	1,125,000.00
7	Spitali Rajonal-Pejë	Furnizim me pajisje mjekësore	200,000.00
8	Kompania e Ujësjellës Rajonal "Prishtina" SH.A	Furnizimi dhe implementimi i GIS Software, licenca dhe Hardware	250,000.00
9	TRAIKOS	Furnizimi me lokomotiva dizel elektrike	1,430,000.00
10	Ministria për Forcën e Sigurisë	Ndërtimi i palestrës sportive dhe fitnesit "Kazema e FSK-se në Prishtinë, e ndare në dy faza 2014-2015	300,000.00
11	Ministria e Punëve të Jashtme	Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare të MPJ-se	1000.00
12	QKUK	Furnizim me pajisje mjekësore	120,000.00
13	Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë	Ndërtimi i shkollës fillore në Mitrovicë	3,000,000.00
14	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Faza e II e rregullimit të shtratit të lumit Drenica, Drenas dhe Verbovc	3,210,194.73
15	Komuna Hani i Elezit	Asfaltimi i rrugës Paldenicë-Dermjak"-sipas LLOT-eve	176,000.00
16	Komuna e Klinës	Asfaltimi i rrugëve në qytet faza 2	100,000.00

17	Komuna e Vitisë	Ndërtimi i kanalizimit te ujerave te zeza ne fshatin Verbanë	194,671.30
18	Komuna e Vitisë	Ndërtimi i Kanalizimit te ujerave te zeza ne fshatrat Trestenik-Sodovinë e Çerkezëve	160,000.00
19	Prokurori i Shtetit	Furnizimi me automjete për prokurorin e shtetit	95,000.00
20	Komuna e Malishevës	Ndërtimi i objektit te shkollës fillore ne fshatin "Bubavec"	200,000.00
21	Ministria e Shëndetësisë	Furnizim me material shpenzuese medicinal nga lista esenciale	272,361.71
22	KEKU	Furnizim me goma	138,000.00
23	Dogana e Kosovës	Servisimi i rregullte, mirëmbajtja dhe furnizimi, ndërrimi dhe balancimi me goma për automjete te Doganës së Kosovës	160,000.00
24	Ministria e Financave	Shërbime për larjen e automjeteve të Ministrisë së Financave	2,500.00
25	QKUK	Furnizim me artikuj ushqimor	780,000.00
26	Instituti Gjyqësor i Kosovës	Pastrimi i objektit	9,600.00
27	Agjencia Kosovare e Privatizimit	Shërbimet e sigurimit fizik për hapësirat e AKP-se dhe te ndërmarrjeve shoqërore nën administrimin e AKP-se	1,872,500.00
28	KEKU	Shërbimet e sigurimit shëndetësor për punëtorët e KEK-ut sh. a.	935,000.00
29	KEK	Riparimi kapital I kaldajës dhe qarqeve rregulluese njësia A% TC Kosova A	4,500.000.00
30	Komuna e Prizrenit	Furnizimi me komposterë për menaxhimin e mbeturinave ne komunën e Prizrenit	1,000,000.00
31	Ndër. Hidroekonomike "Iber-Lepenci"	Kontrollimi teknik i automjeteve te II-se	5000.00
32	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	Laboratori i Institutit Gjeologjik të Kosovës	700,000.00
33	Komuna e Klinës	Furnizim-montimi i xhamave në objektet shkollore dhe institucioneve tjera	15,000.00
34	QKUK	Furnizim me pajisje mjekësore	50,000.00
35	Kompania për Menaxhimin e Deponive ne Kosove	Furnizim me derivate të naftës për KMDK	700,000.00
36	Kuvendi i Republikës së Kosovës	Renovimi i ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës	450,000.00
37	Komuna e Klinës	Ndërtimi i kanalizimit fekal faza e katërt ne Sferke-ritender	40,000.00
38	Komuna e Pejës	Asfaltimi I rrugëve " Beteja e Shqiponjës dhe tri anekse të rrugës Agim Binak Qela, kubëzimi i rr. Shefqet Mustafa dhe Selman Morina	48,000.00
39	Komuna e Lipjanit	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Lluge	100,000.00
40	Njësia e Inteligjencës Financiare	Furnizimi me pajisje te teknologjisë informative	30,000.00
41	Spitali Rajonal Ferizaj	Furnizimi me instrumente për ortopedi, kirurgji urologji, kirurgji abdominale dhe gjinekologji	150,000.00
42	Agjencia Kosovare e Pronës	Sigurimi I objekteve te AKP-se me roje fizike dhe mirëmbajtja e sistemit te alarmimit	82,200.19
43	Spitali Sheikh Zayed-Vushtri	Furnizimi me inventar medicinal dhe administrativ	30,000.00
44	Spitali Rajonal Gjilan	Furnizimi me pajisje mjekësore	50,000.00

45	Komuna e Leposaviqit	Furnizimi me automjet zyrtar për nevojat e Komunës së Leposaviqit	44,000.00
46	NP" TERMOKOS" SH A	Furnizim me mazut	3,000,000.00
47	Prokuroria e Shtetit	Furnizim me Automjete- Ritender	95,000.00
48	Spitali I Përgjithshëm "Prim .Dr. Daut Mustafa" ne Prizren	Blerja e pajisjeve mjekësore	200,000.00
49	Komuna e Prishtinës	Rregullimi i platos pranë PTK-se ne lagjen Dardania	376,798.62
50	Komuna e Gjakovës	Punimi i planit rregullues urban te hollësishëm te zonës nga rruga " Nena Terezë", Fehmi Agani", Sadik Stavileci" deri te rruga "Tivari"	15,000.00
51	KOSTT	Opgrade dhe update i produktit ekzistues RTU	440,000.00
52	Komuna e Gjilanit	Hartimi i planeve rregulluese në Komunën e Gjilanit-ndarja në tri llote	212,500.00
53	Ministria e Shëndetësisë	Furnizimi dhe shtrirja e Hardwerit për SISH nëpër spitalet regionale	80,000.00
54	Komuna e Prishtinës	Rregullimi i platos pranë çerdhes se fëmijëve " Lulevera" në Dardani	210,253.48
55	Komuna e Prishtinës	Krijimi i kadastrit te përvojave nëntokësore	100,000.00
56	Spitali rajonal Gjilan	Furnizim me pajisjes mjekësor: Rëntgen-Grafi Digjital	120,000.00
57	Komuna e Lipjanit	Tërheqja e automjeteve sipas porosisë (shërbime te merimangës)	Nga te hyrat vetanake te realizuara
58	KEKU	Riparimi kapital I kaldajës te njësia A5 tc Kosova A	4,651,031.60
59	Posta dhe telekomunikacioni i Kosovës Sh.A	Furnizim me telefona mobil (smartphones)	55,000.00
60	Universiteti i Prishtinës	Sigurimi fizik i hapësirave te objekteve ne UP"	50,000.00
61	Komuna e Ferizajit	Furnizimi me një aparat mamografise për diagnostifikimin e kancerit te gjirit, 10 aparate për EKG dhe 5 sterilizator për nevojat te QKMF-se	52,000.00
62	Ministria e Drejtësisë	Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve te (MD, SHKK, AAPSK)	67,025.20
63	Ministri e Shëndetësisë	Furnizim me bari Mycophenolate mofetil	143,000.00
64	Komuna e Ferizajt	Furnizimi me një aparat mamografise pre diagnostifikimin e kancerit te gjirit, 10 aparate pre EKG dhe 5 sterilizator për nevojat te QKMF-se (Menaxhimi i kontratës)	64,900.00
			28,680,803.83

Tabela 15. Aktivitetet e ndërprera të prokurimit mbi bazën e opinioneve të AKK-së

Tabela në vijim pasqyron rastet në të cilat nuk është ndërprerë aktiviteti i prokurimit pas Rekomandimeve të AKK-së, vlera e te cilëve është 3,961,700.19

Nr	Institucioni	Emri i tenderit	Vlera e tenderit
1	Komuna e Podujevës	Furnizim me derivate të naftës për institucionet komunale	34,460.00
2	KOSTT Sh. a.	Instalimi i grupeve matëse në kufirin në mes të KOSTT/KEK/OSSH	2,327,240.19
3	QKUK	Servisimi i pajisjeve radiologjike	1,600,000.00
Totali:			3,961,700.19

Tabela 16. Pasqyra e rasteve që nuk është ndërprerë aktiviteti i prokurimit nga Autoritetet Kontraktuese

7. Mbështetja profesionale dhe Marrëdhëniet me Publikun

Në kuadër të Zyrës së Drejtorit ekzistojnë njësi të caktuara që kryejnë shërbime administrativo-profesionale si dhe kultivojnë frymën e transparencës duke dhënë mbështetje profesionale për stafin e agjencisë. Këtë mbështetje e ofrojnë këto zyre dhe njësi:

- Zyra për mbështetje, bashkëpunim dhe informim;
- Resurset njerëzore; dhe
- Prokurimi

7.1 Zyra për Mbështetje, Bashkëpunim dhe Informim

Aktivitetet e AKK-së që kanë të bëjnë me Zyrën për bashkëpunim dhe Informim ku udhëhiqet nga shefi i zyrës, zyrtari i lartë ligjor, administratori i sistemit të teknologjisë informative dhe zyrtari i lartë për arkiva. Sa i përket aktiviteteve të saj gjatë periudhës raportuese, Zyra për mbështetje bashkëpunim dhe informim, është përqendruar në këto aktivitete:

- Bashkëpunimi ndërkombëtar;
- Takimet me gazetarë dhe qytetarë;
- Konferencat dhe komunikatat për shtyp;
- Monitorimi i mediave;
- Ndihma Ligjore
- Administrimi i teknologjisë informative
- Arkiva qendrore.


Bashkëpunimi dhe informimi - AKK vazhdimisht ka kultivuar frymën e bashkëpunimit të mirë me institucione dhe organizata ndërkombëtare. Gjatë vitit 2014, zyrtarët e Agjencisë kanë marr pjesë në disa konferenca vendore dhe ndërkombëtare, nga ku kanë marrë përvoja në luftën dhe parandalimin e Korrupsionit. Student ndërkombëtar, kane shfaqur interesim të vazhdueshëm për

AKK-në, ata kanë gjetur gatishmërinë e Drejtorit dhe stafit të Agjencisë për ti njoftuar rreth punës së Agjencisë në përgjithësi.

Takimet me gazetarë dhe qytetarë - Gjatë periudhës raportuese, për iniciativat dhe aktivitetet e AKK-së, ka pasur një interesim të madh si nga ana e komunitetit të gazetarëve të shoqërisë civile ashtu edhe nga ana e publikut, ku është demonstruar një gatishmëri e plotë për të bashkëpunuar ngushtësisht në luftën kundër korrupsionit. Zyrtarët e AKK-së kanë qenë gjithmonë të gatshëm që çdo të interesuari ti ofrohet ndihma profesionale si edhe bashkëpunimi në rastet kur ka pasur dyshime të bazuara për raste korruptive.

Konferencat dhe komunikatat për shtyp - AKK gjatë periudhës raportuese, ka luajtur një rol të rëndësishëm në bërjen publike dhe në shpërndarjen e komunikatave për shtyp lidhur me aktivitetet për hetimin e rasteve të dyshuara korruptive por edhe përkitazi me rezultatet e deklarimit të pasurisë së zyrtareve të lartë, në të gjitha mediat e shkruara dhe elektronike. Gjatë kësaj periudhe në web faqen e AKK-së janë publikuar publike mbi 3000 deklarime të pasurisë, 288 vendime për konflikt interesi, 64 opinione si dhe dhjetëra komunikata, njoftime, reagime, takime, që janë publikuar në web faqen e AKK-së dhe shumë prej tyre janë përcjell edhe në media. Një interesim shumë i madh i medias dhe publikut në përgjithësi ka qenë i shprehur me rastin e bërjes publike të deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe konfliktit të interesit dhe raportit vjetor të AKK-së.


Monitorimi i mediave - Shkrimet e mediave për punën e AKK-së mblidhen dhe këto raportet mediale rregullohen në formë fletushke, ku mediat kanë bërë prezantimin e punës së Agjencisë kundër Korrupsionit gjatë vitit 2014. Po ashtu një angazhim tjetër është monitorimi i shkrimeve mediale që kanë të bëjnë me raportimet përkitazi me aktivitetet e dyshuara korruptive nga individ në institucionet publike. Gjatë vitit 2014 janë publikuar në mediat e shkruara dhe elektronike rreth 169 shkrime për dyshime për korrupsion. Tabela e më poshtme pasqyron në formë grafike numrin e shkrimeve për korrupsion të cilat janë publikuar nga mediat e shkruara të Kosovës gjatë vitit 2014.



Grafiku 5. Shkrimet për Korrupsion në shtypin ditor sipas muajve gjatë vitit 2014

Sa i përket punës së AKK-së janë botuar gjithsej 179 artikuj, intervista, komente dhe opinione të ndryshme për punën e Agjencisë. Në sensin e një vlerësimi në kuptim të pozitivitetit të raporteve

për këtë institucion del se mbi 80% të shkrimeve kanë qenë pozitive për punën e AKK-së. Grafikët e më poshtme pasqyrojnë në formë grafike numrin e shkrimeve që janë botuar në mediat e shkruara të Kosovës për punën e AKK-së sipas muajve gjatë vitit 2014.



Grafiku 6. Numri i shkrimeve i të gjitha mediave të shkruara për punën e Agjencisë

Punët juridike kanë qenë të orientuara në ofrimin e Këshillave Juridike lidhur me fushë veprimtarinë dhe përgjegjësitë ligjore të Agjencisë, në ofrimin e mbështetjes profesionale juridike për nëpunësit e Agjencisë, në përpilimin e vendimeve dhe parashtrësive tjera juridike për nevojat e Agjencisë si dhe në përfaqësimin e rasteve të iniciuara nga Agjencia në institucionet e drejtësisë.

Përfaqësimet - Gjatë vitit 2014 janë përfaqësuar shumë raste të iniciuara nga Agjencia në institucionet e drejtësisë. Përfaqësimi është bërë në Gjykatat Themelore e sipas nevojës edhe në Prokurorinë e Shtetit.

Parashtrësat juridike - Gjatë vitit 2014 sipas nevojës dhe kërkesave janë përgatitur dhe nxjerrë parashtrësa juridike (vendime, kërkesa, raporte e të tjera) si dhe janë përgatitur këshilla ligjore.

○ Menaxhimi i sistemit të TI-së

Në aspektin e teknologjisë informative (TI), digjitalizimit të të dhënave, në AKK ka pasur ngritje, gjegjësisht është bërë avancim si në aspektin e harduerit, ashtu edhe në atë softuerit.

Gjatë vitit 2014 AKK, ka bërë modifikimin e ueb aplikacionit – SDRP-së, në përputhje me ndryshimet që janë bërë në formularët e deklarimit të pasurisë, sipas ligjit aktual të deklarimit të pasurisë.

Me këtë, baza e të dhënave e AKK-së SDRP (Sistemi i Deklarimit dhe Regjistrimit të Pasurisë) është avancuar në aspektin teknik dhe praktik. Madje kemi bërë edhe avancime të tjera në SDRP, posaçërisht në aspektin e nxjerrjes së raporteve analitike për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik.

Pastaj kemi zhvilluar SDRP-në në seksionin e Deklarimit dhe Regjistrimit të Pasurisë, ku kemi mundësuar që në mënyrë digjitale dhe në kohë reale të nxirret raporti i zyrtarëve të lartë publikë që

e kanë deklaruar pasurinë, të cilëve duhet t'ju kontrollohet pasuria sipas shortit të hedhur paraprakisht.

Po ashtu ngritja e SDRP-së është bërë edhe për departamentin e Luftimit të Korrupsionit të AKK-së, me këtë është hapur mundësia e digjitalizimit të të dhënave të këtij departamenti.

Edhe këtë vit kemi vazhduar në mënyrë të njëjtë të bëjmë publikim e deklarimit të pasurisë, duke shfrytëzuar SDRP-në, me këtë rast SDRP në mënyrë automatike bënë përpunimin e të dhënave të futura në te, dhe nxjerr regjistra të veçantë për secilin zyrtar në formatin pdf, të cilët regjistra i publikojmë në ueb faqen e AKK-së: <http://www.akk-ks.org/?cid=1,1178>.

Gjatë vitit 2014 të gjithë përdoruesit e AKK-së i kemi kaluar nga sistemi operativ Windows XP në Windows 7, si dhe nga MS Office 2007 në MS Office 2010.

Kemi ideuar dhe dizajnuar ngritjen e rrjetit lokal kompjuterik, dhe atij telefonik. Ku me sukses kemi përmbyllë projektin e shtrirjes së rrjetit të ri, me kablo dhe pajisje tjera përcjellëse të kategorisë 6-të. Dhe kemi ndërtuar infrastrukturën e nevojshme telefonike që në të ardhmen të mund të kalojmë në "Voice Over IP".

Për çdo vit sistemi i teknologjisë informative është avancuar dhe ka përcjell teknologjinë së bashku me profesionalizmin.

○ **ARKIVA**

Zyra e arkivës së AKK 2014, e ka përmbyllur me numër protokollit 04-5097/14 (pesëmijë e nëntëdhjetë e shtatë) të datës 31.12.2014. Gjatë vitit 2014 janë përdorur dy libra të protokollit. Libri I parë ka filluar me numrin 01-01-2014 dhe ka përfunduar me numrin rendor 03-2000/14 (dymijë), të datës 02.06.2014, ndërsa libri I dytë i protokollit ka filluar nga numri 03-2001/14 (dymijë e një), të datës 02.06.2014 dhe ka përfunduar me numrin rendor 04-5097/14 (pese mije e nëntëdhjetë e shtatë). Të gjitha shkresat e hyrëse dhe dalëse protokollohen në librin e protokollit, ato të brendshmet përcillen te drejtori i AKK-së për nënshkrim, kurse shkresat nga jashtë sipas rregullores së brendshme për menaxhimin e arkivës përcillen tek Drejtori, shefat divizioneve dhe zyrtari përkatës për procedurë të mëtutjeshme. Shkresat e pranuar ne Agjenci, pas regjistrimit ne librin e protokollit përcillen ne njësinë organizative përkatëse, me mbajtje të evidencës për lëndët e pranuar dhe te dorëzuara. Deklarimi i pasurisë është protokolluar më protokoll të veçantë të menaxhuar nga Divizioni i Mbikëqyrjes së Pasurisë.

Shkresat e departamentit për luftimin e korrupsionit- Shkresat e Departamentit janë skanuar dhe arkivuar sipas numrit të protokollit, (te nënshkruara nga drejtori janë protokolluar me numër 01, ndërsa shkresat që kanë hyrë në këtë departament janë protokolluar me numër 02) siç janë: kërkesat për dokumentacione, kthim dokumentacioni, u janë përcjell zyrtarëve të ngarkuar, Shefit të Divizionit dhe Drejtorit të Departamentit. Duke u bazuar në deklaratën për ruajtjen e konfidencialitetit të Agjencisë, në arkivin elektronike nuk janë ruajtur dhe skanuar; kallëzimet penale, shkresat konfidenciale, njoftimet për palë, kërkesat për konfirmim.

Shkresat e departamentit të parandalimit- lëndët e nënshkruara nga Drejtori i Agjencisë janë protokolluar me numër 01, ndërsa shkresat që kanë hyre për këtë departament janë protokolluar me numër 03, siç janë: kërkesat për dokumentacion, kthim dokumentacioni, opinionet nga Divizioni I Parandalimit të Konfliktit të Interesit, vendimet për mbyllje të rastit të Konfliktit të Interesit,

kërkesat për procedurë kundërvajtëse rreth mos deklarimit të pasurisë, njoftimet për zyrtarë nga Divizioni I Mbikëqyrjes së Pasurisë.

Shkresat e divizioni për punë të përgjithshme dhe financa- - Duke u bazuar në vendimin e drejtorit të Agjencisë , më numër protokoll 01-3048/2010, të datës, 01.09.2010 zyrtarja e arkivit është obliguar ti mbaj paratë e imta të agjencisë –PTKSH-in. Në vitin 2014 AKK ka qenë e ngarkuar me para të imta në shumë prej 2000 euro. Nga kjo shumë AKK ka shpenzuar gjithsej 1577.33 euro dhe janë kthyer 422.67 euro. Gjatë kësaj periudhë është përgatitur raporti tre-mujor, gjashtë-mujor, nëntë-mujor dhe ai përfundimtar dymbëdhjetë-mujor për pagesat e bëra me PTKSH ku është përcjellë në Divizionin për Punë të Përgjithshme dhe Financa.

7.2 Resurset njerëzore

Gjatë periudhës raportuese zyra e personelit i ka përmbushur obligimet dhe përgjegjësit e saj të përshkruara sipas rregullores së punës të përcaktuara me ligj.

Objekti kryesor i kësaj zyrëje ka qenë ngritja e kapaciteteve të stafit përmes trajnimeve dhe punëtorive të ndryshme që janë mbajtur si brenda ashtu edhe jashtë vendit ku janë përfshirë një numër i konsiderueshëm i stafit të AKK-së. Shihni të bashkangjitur evidencën e trajnimeve për këtë periudhë kohore. ([Aneksi II](#))

7.3 Prokurimi Publik

Agjencia si autoritet kontraktues gjatë periudhës raportuese ka zhvilluar aktivitete të prokurimit sipas llojeve të prokurimit furnizim dhe shërbime.

Në mënyrë tabelare aktivitetet e prokurimit duken kështu:

Procedura	Lloji i aktivitetit të prokurimit	Numri i aktiviteteve	Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj.
Furnizim	Kuotim Çmimi	11	36, 478.13
Shërbime	Kuotim Çmimi	5	11,496.15
Furnizim	Vlerë minimale	6	2,315.24
Shërbime	Vlerë minimale	3	1,226.80
Furnizim	Procedurë e hapur	1	12,898.45
Shërbime	Procedurë e hapur	2	0.01
Totali			64,414.77

***Tabela 17.** Pasqyra e aktiviteteve të Prokurimit Publik*

8. Administrata Buxheti dhe Financat

Administrata dhe financat e agjencisë menaxhohen nga një divizion i veçantë (Divizioni për punë të përgjithshme dhe financa) që punën e tij e përqendron në kryerjen e shërbimeve administrative, që kanë të bëjnë me buxhetin dhe financat, përkthimet, depoja, dhe menaxhimin e pasurive të agjencisë.

Duke u bazuar në vlerësimet e brendshme nga njësitë organizative, janë përgatitur kërkesat për ndarje buxhetore. Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Qeveria kanë aprovuar kërkesën e AKK-së, duke ndarë fonde për vitin 2014. Tabela në vazhdim pasqyron ndarjet buxhetore sipas kategorive ekonomike:

Nr.	Kategoritë ekonomike	Buxheti i aprovuar (fillestar)	Buxheti i rishikuar (final)
1	Pagat dhe mëditjet	293,709.00	340,204.00
2	Mallrat dhe shërbimet	181,291.00	124,097.00
3	Shpenzimet komunale	10,000.00	8,500.00
	Totali	485,000.00	472,801.00
4	Granti BB (Banka Botërore)	113,900.00	113,900.00
	Totali i përgjithshëm	598,900.00	586,701.00

Tabela 18. Pasqyra e ndarjeve buxhetore sipas kategorive ekonomike

Nga tabela vërehet që ndryshimi në mes të buxhetit fillestar dhe buxhetit final, ky ndryshim ka rrjedhur si rezultat i Vendimit të Qeverisë për rritjen e pagave dhe mëditjeve, duke reduktuar fondin në kategorinë Mallra dhe Shërbime dhe në kategorinë e Shpenzimeve Komunal, po ashtu evidentimi i kursimeve në rastin e rishikimit të buxhetit.

○ Realizimi i Shpenzimeve

Nr.	Kategoritë ekonomike	Buxheti	Shpenzimet	% e realizimit
1	Paga dhe mëditje	340,204.00	340,202.41	99.9
2	Mallra dhe shërbime	124,097.00	109,288.42	88.06
3	Shpenzimet komunale	8,500.00	3,588.24	42.21
	Totali	472,801.00	453,079.07	95.82
4	Granti BB (Banka Botërore)	113,900.00	101,994.01	89.54
	Totali i përgjithshëm	586,701.00	555,073.08	94.61

Tabela 19. Pasqyron realizimi e buxhetit sipas kategorive ekonomike

Gjatë vitit 2014 ekzekutimi i buxhetit ka qenë i nivelit të kënaqshëm. Nga ndarjet e përgjithshme prej 472,801.00€ janë shpenzuar 453,079.07 €, shprehur në përqindje 95.82% .

Agjencia Kundër Korrupsionit, si përfituese e projektit të Bankës Botërore, IDF Grant-P131030 Enhancing the Implementation of Public Procurement Project, ka të angazhuar dy konsulentë: një ndërkombëtarë dhe një vendor.

Nga ky projekt Banka Botërore ka alokuar fonde në shumën prej 113,900.00€. Për Pagat dhe Mëditjet e tyre nga ky fond janë shpenzuar 101,994.01 €, apo shprehur në përqindje 89.54 %. Nga totali i përgjithshëm i buxhetit vjetor prej 586,701.00 €, janë shpenzuar 555,073.08 €, ose 94.61%.

9. ADRESIMI I REKOMANDIMEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Gjatë periudhës raportuese Zyra e Auditorit të Përgjithshëm pas auditimit ka dhënë disa rekomandimet për Agjencinë. Në vijim janë paraqitur në mënyrë tabelare rekomandimet dhe veprimet e menaxhmentit të Agjencisë lidhur me to.

Rekomandimet	Veprimi i menaxhmentit	Data e planifikuar për përfundim	Personi përgjegjës
1.Rekomandimi 1 Drejtori i AKK-së duhet të sigurojë kontrolle shtesë në kuadër të sektorit të pagesave, në mënyrë që shpenzimet të klasifikohen dhe regjistrohen në përputhje me planin kontabël të miratuar.	Drejtori dhe Menaxhmenti i Lartë do të ndërmarrin masat e nevojshme që klasifikimi i shpenzimeve dhe regjistrimi i tyre të jete në përputhje të plote me planin kontabël dhe dispozitat tjera ligjore dhe financiare.	Ne vazhdimësi	Menaxhmenti i Lartë
2.Rekomandimi 2 Drejtori i AKK-së duhet të sigurojë konkurrencë dhe transparencë të plotë gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, në mënyrë që paraja publike të shfrytëzohet në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive.	Ka qene dhe do te jete nder prioritetet e para qe shfrytëzimi i parasë publike te behet ne mënyrë transparente, efikase dhe ekonomike, duke i respektuar te gjitha procedurat qe parashihet me Ligjin e Prokurimit Publik.	Proces ne vijim	Menaxhmenti i Lartë, Zyra e Prokurimit
3.Rekomandimi 3 Drejtori i AKK-së duhet të rishikoj çështjen e transportit dhe të lidhë kontratë për furnizim me bileta me ndonjë agjent të udhëtimeve. Kontrata duhet të lidhet përmes procedurave të rregullta të prokurimit	Ju sigurojmë se ne te gjitha rastet e blerjes se biletave kemi vendos për ato me çmimin me te ulet. Zyra e prokurimit ka filluar procedurat për zgjedhjen e një operatori për ofrimin e këtyre shërbimeve, dhe tani kemi kontratë.	Ne proces	Menaxhmenti i Lartë, Zyra e Prokurimit
4.Rekomandimi 4 Drejtori i AKK-së duhet të forcoj kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPP-në, dhe me rregullat e Thesarit.	Menaxhmenti i Lartë dhe zyrtaret financiare janë zotuar se procesi i pagesave do të bëhet në pajtim të plotë me LMFPP dhe me rregullat e Thesarit.	Ne proces	Menaxhmenti i Lartë, ZKA, ZKF dhe zyrtaret tjerë financiar.
5.Rekomandimi 5 Drejtori i AKK-së duhet të forcojë kontrollet e brendshme, në mënyrë që pagesa për pushim të lehonisë të llogaritet dhe të realizohet në përputhje me dispozitat në fuqi.	Nga zyra e personelit janë ndërmarr masat e nevojshme dhe të gjitha pagesat bëhen sipas Rregullores për Pushimin e Nëpunësve Civil.	Ne proces	Menaxhmenti i Lartë, Zyra e personelit
6.Rekomandimi 6 Drejtori i AKK-së duhet të sigurojë se regjistrat e pasurisë janë harmonizuar në mes veti, në mënyrë që informatat e raportuara të jenë të plota dhe të sakta.	Ju sigurojmë se ky proces do te jete ne përputhje te plote me Rregulloren për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare te Organizatave Buxhetore.	Ne afatin e duhur	Menaxhmenti i Lartë, Zyrtarja e Pasurisë

Tabela 20. Pasqyra e rekomandimeve nga zyra e auditorit të përgjithshëm


10. MËSIMET DHE REKOMANDIMET

Gjatë realizimit të misionit të saj, Agjencia ka vërejtur se ka disa gjëra që duhet përmirësohen në të ardhmen, të merren disa hapa të përbashkët institucional në mënyrë që të ketë një koordinim më efektiv mes institucioneve që kanë mision luftimin e korrupsionit por edhe çështje të tjera të radhitura në vijim:

- **Të mos ketë ndryshim të shpeshtë të kuadrit Ligjor**- Si rrjedhojë e plotësimit dhe ndryshimit të shpeshtë të kuadrit ligjor anti-korrupsion është vërejtur se nuk po tregohen efektive. Agjencia rekomandon që ky kuadër ligjor nuk duhet ndryshuar shpesh. Duhet lënë një periudhë më të gjatë kohore për zbatimin e tij, pastaj të analizohet dhe të avancohet sipas kërkesave të Agjencisë kur vërehet nevoja reale e avancimit të tij;
- **Krijimi i bazës së përbashkët të të dhënave** - Me qëllim të krijimit të një sistemi të përbashkët institucional, Agjencia rekomandon krijimin e një baze të dhënash të përbashkët të të gjithë mekanizmave që kanë për mision luftimin e korrupsionit, në mënyrë që të dhënat të shfrytëzohen bashkërisht në bazë të misionit të secilit institucion;
- **Metodologji e përbashkët hetuese** - Për të pasur efikasitet dhe metodologji të përbashkët në praktikën hetuese, AKK rekomandon organizimin e trajnimeve të përbashkëta Prokurori, Polici dhe Agjenci. Gjithashtu është shumë e rëndësishme që për shkak të efikasitetit të krijohen grupe të përbashkëta hetuese në mes këtyre institucioneve;
- **Publikimi i aktakuzave dhe aktgjykimeve** - Publikimi i aktakuzave dhe aktgjykimeve i emrave të personave të akuzuar si dhe i emrave të personave të gjykuar për korrupsion do të ndikonte shumë pozitivisht në rritjen e besimit të qytetareve tek sistemi i drejtësisë në tërësi;

11. PËRFUNDIMI

Agjencia mbetet rrënjësisht e vendosur në zbatimin me përpikëri të ligjeve që i përcaktojnë misionin e saj. AKK do të vazhdojë të jetë e përkushtuar që si pjesë e zingjirit të mekanizmave të tjerë shtetëror të japi maksimumin në forcimin e sundimit të rendit dhe ligjit. Jemi të vetëdijshëm se për të pasur rezultate në luftën kundër korrupsionit nevojitet një bashkëpunim dhe zotim i fort i të gjithë mekanizmave. Andaj AKK zotohet për gatishmëri të fortë bashkëpunuese me të gjithë akterët në mënyrë që Kosova të shënojë rezultate konkrete në luftimin dhe parandalimin e Korrupsionit.

SHTOJCAT**Aneksi I . Organogrami i Agjencisë kundër Korrupsionit**

Aneksi II Tabela e trajnimeve gjatë vitit 2014

Nr.	Lloji i Trajnimit	Organizon	Vendi	Data	Emri i zyrtarëve
1.	Komunikimi –konfliktet, ekipet dhe puna ekipore	IKAP	Prishtinë	10-11.02.2014	2
2.	Menaxhimi i projekteve	IKAP	Prishtinë	13,14,20 dhe 21.02.2014	2
3.	Përmirësimi i kapaciteteve administrative në fushën e prokurimit publik në Kosovë	KRPP	Prishtinë	21.01.2014	3
	Public procurement audit, monitoring, finding irregularities, frauds, mistakes	KRPP	Prishtinë	18-19-20.02.2014	2
4.	Statistical package for the social sciences	IKAP	Prishtinë	19-20-21.02.2014	1
5.	Improving Administrative Capacities in the Area of Public Procurement	The European Commission Kosovo	Prishtinë	18-20.02.2014	2
6.	Punëtorja "Përcjellja e Parasë"	Instituti Kundër Krimeve Ekonomike	Prizren	21.02.2014	1
7.	Trajnim fillestar për ipa2 (2014-2020)	IKAP	Prishtinë	24-25.02.2014 dhe 26-27.02.2014	2
8.	E drejta për mbrojtjen e informatorit dhe ndërlidhja me legjislacionin në administratë publike	IKAP	Prishtinë	26-27.02.2014	2
9.	Java Programming	AUK	Prishtinë	25.02.2014	1
10.	Punëtori mbi mbledhjen, mbajtjen dhe raportimin e statistikave për qëllime të vlerësimit	Këshilli i Evropës Projekti Kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PECK)	Prishtinë	26-27.02.2014	1
11.	Konferencë Shteti juridik dhe demokracia	Universiteti shtetëror i Tetovës	Tetovë	12.03.2014	1
12.	Etika dhe Anti- korrupsioni në Administratën Publike	IKAP	Prishtinë	12-13.03.2014	1
13.	Funksionimi i administratës shtetërore në RK	IKAP	Prishtinë	24-25.03.2014	2
14.	Punëtorja Përcjellja e parasë	PK	Pejë	04.04.2014	1
15.	Vlerësimi i performancës	IKAP	Prishtinë	31.03-14.04-2014	1
16.	„SPSS (Statistical Package for the Social Sciences)	IKAP	Prishtinë	31.03-02.04.2014	1
17.	Teknikat e avancuara të hetimeve financiare	PK	Prishtinë	22.04-25.04.2014	1
18.	Trajnime të trajnerëve	UNDP	Prishtinë	22.04.2014	7
19.	SIMBNJ-Sistemi Informativ i Burimeve Njerëzore	MAP	Prishtinë	29.04-06.05.2014	1
20.	E drejta e Be-se dhe Zbatimi i saj	IKAP	Prishtinë	05-08.05.2014	2

21.	Analizimi i formave aktuale të korrupsionit Brenda Policisë së Kosovës dhe drejtësisë dhe zhvillimi i propozimeve për parandalimin e krimit bazuar në analiza	Policia e Kosovës	Prishtinë	06-07.05.2014	1
22.	Ngritja e bashkëpunimit e mekanizmave kundër korrupsion	AKK&UNDP	Ohër	23-25.05.2014	7
23.	Te drejtat e njeriut në Kosovë	IKAP	Prishtinë	26.-27.05.2014	1
24.	Rregullorja e punës për AKK-në	AKK	Ohër	05-08.06.2014	7
25.	Trajnim Bazik për Prokurim Publik	IKAP	Prishtinë	Qershor-korrik	1
26.	Hoë to train effectively in Integrity Management and Integrity Planning- challenges and solutions	UNDP	Prishtinë	22.04.2014 21.05.2014 19-20.06.2014	2
27.	Ethical Leadership Accredited Training	RESPA	Danilovgrad	23-27.06.2014	2
28.	“Hetimi i Pastrimit të parave, gjurmimi i aseteve dhe asistencë e përbashkët ndërkombëtare ligjore”	Instituti Kundër krimeve ekonomike	Prishtinë	23-27.06.2014	2
29.	Aktiviteti 4.4	Policia e Kosovës	Prishtinë	24-26.06.2014	1
30.	Udhëheqja e hetimeve të krimeve financiare	Policia e Kosovës	Prishtinë	14-16.07. 2014	1
31.	Certifikatat themelore profesionale të Prokurimit	IKAP	Prishtinë	2014-2016	1
32.	Hetimi i Kontrabandës, veprave doganore dhe taksave	Policia e Kosovës	Prishtinë	08-10.09.2014	1
33.	Etika dhe Protokoli	Friedrich Ebert Stiftung	Prishtinë	21.09.2014	1
34.	Konferenca ndërkombëtare mbi “Përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”	Projekti PECK	Prishtinë	23.09.2014	2
35.	Konflikti i Interesit në Administratën Publike	IKAP	Prishtinë	29-30.09.2014	2
36.	Konferenca ndërkombëtare mbi “Përmirësimin e bashkëpunimit në fushën kundër korrupsionit	Projekti PECK	Prishtinë	28.10.2014	2
37.	Rritja e komunikimit dhe ndarjes së informatave në mes të KGJK-së dhe palëve të jashtme të interesit dhe Parimet e Bangalores për sjelljen gjyqësore	UNDP-ja (UNODC)	Prishtinë	29-30.10.2014	2

38.	Punëtorja mbi Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit në Kosovë/Prezantimi i kërkesave të Aquis për Kapitullin 23 - Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore	Projekti i GIZ në Kosovë në bashkëpunim me Institutin për Politikë Evropiane me seli në Berlin	Prishtinë	30-31.10.2014	3
-----	---	--	-----------	---------------	---

Tabela All. Lista e trajnimeve gjatë vitit 2014

Agjencia kundër Korrupsionit

Raporto Korrupsion në:

0800 10 8000 www.akk-ks.org

Rruga "Nazim Gafurri" Nr. 31
Prishtinë 10000 Kosovë